

**RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSIONI I RRJETIT TE UJËSJELLËSIT TË FSHATIT DAJÇ,
NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJÇ”**

1



RAPORTI I VLERESIMIT NDIKIM NE MJEDIS U PERGATIT NGA GRUPI I PUNES I PERBERE NGA:

Expert Mjdisi Kristaq GJOKA

Expert Mjdisi Yzeir MIRAKA

PROJEKTUES:

ZENIT & CO SH.P.K.

INVESTITOR:

BASHKIA LEZHE

TIRANE, 2021

PËRMBAJTJA

PARATHENIE

KREU I

LEGJISLACIONI

- 1.1 Qëllimi dhe objektivat e VNM-së
- 1.2 Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin
- 1.3 Klasifikimi i projektit

KREU II

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

- 2.1 Qëllimi i projektit të propozuar
- 2.2 Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij
- 2.3 Skica dhe planimetri të objekteve dhe strukturave të projektit, mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit
- 2.4 Pëshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit
 - 2.4.1 Pëshkrimi i skemës së shfrytëzimit të ujit.
 - 2.4.2 Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin.
 - 2.4.3 Përcaktimi i kapacitetit prodhues
 - 2.4.4 Produkti përfundimtar i prodhuar.

KREU III

PËRSHKRIMI FIZIK DHE BIOLOGJIK I ZONËS

- 3.1 Mjedisi fizik
- 3.2 Topografia dhe morfologjia
- 3.2 Mjedisi biologjik
 - 3.3.1 Flora
 - 3.3.2 Fauna
- 3.4 Popullsia
- 3.6 Ekonomia

KREU IV

VLERËSIMI I NDIKIMEVE DHE NEGATIVE NGA ZBATIMI I PROJEKTIT DHE MASAT ZBUTËSE

- 4.1 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis
 - 4.1.1 Metoda e identifikimit të ndikimeve negative
- 4.2 Ndikimi në ajër (cilësia e ajrit, vibrimet)
- 4.3 Ndikimet në ujëra (ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore)
- 4.4 Ndikimet në tokë
- 4.5 Ndikimi në biodiversitet (flora dhe fauna tokësore dhe ajo ujore)
- 4.6 Ndikimet në mjedisin social-ekonomik (mjedisi social-kulturor dhe ekonomik, përdorimit të tokës dhe burimeve ujore)
- 4.7 Ndikimet që shkaktojnë ndryshimet klimatike (Ndrshimi i klimës, emetimi i substancave ozon-holluese)
- 4.8 Ndikimi në balancën e ekosistemit. Prurjet ekologjike
- 4.9 Ndikimi në erozion
- 4.10 Ndikimi në habitat. Objektet me status të veçantë
- 4.11 Ndikimet ndërkufitare

- 4.12 Ndikimi ne regjimin e zhurmave dhe vibrimeve.
- 4.13 Menaxhimi i mbetjeve të ngurta
- 4.14 Tabela përmbledhëse e ndikimeve negative dhe pozitive në mjedis

KREU V TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS, QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT, DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË

- 5.1 Ndikimi i projektit gatë fazës së ndërtimit
- 5.2 Ndikimi i projektit gatë fazës së ndërtimit
- 5.3 Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara

KREU VI PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT

- 6.1 Të përgjithshme
- 6.2 Plani i menaxhimit të mjedisit të dëmtuar nga zbatimi i këtij projekti
- 6.3 Vlerësimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella

KREU VII MUNDËSITË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, SI DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN

- 7.1 Të dhënat e sheshit të depozitimit
- 7.2 Vlerësimi teknik i planifikimit të shesh depozitimit
- 7.3 Sistemimi i materialeve në shesh depozitim
- 7.4 Mbyllja e shesh depozitimit
- 7.5 Sistemimi i materialit të mbulesës dhe sterileve
- 7.6 Sistemi i skarpateve para e pas ndërtimit
- 7.7 Depozitimi i dheut (kores së tokës) dhe punimet e sistemimit të shtratit të dheut
 - 7.7.1 Zëvendësime (10%)
 - 7.7.2 Ndikimet

KREU VIII MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

- 8.1 Masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit
- 8.2 Plani i monitorimit të mjedisit
- 8.3 Masat për parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve nga zjarri
 - 8.3.1 Faza I. Ndërtim montim i ujesjellesit
 - 8.3.2 Masat e parashikuara për fazën I.
- 8.4 Faza II. Shfrytëzimi i Ujesjellesit

KREU IX MONITORIMI I MJEDISIT GJATË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË REHABILITIMIT TË MJEDISIT.

KREU X KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- 11.1 Konkluzione
- 11.2 Rekomandime

PARATHENIE

Ky raport teknik pershkruan projektin e rikonstruksionit te rrjetit te ujesjellesit per fshatin Dajc, i cili ben pjese ne Njesine Administrative Dajc (Bashkia Lezhe).

Si çeshtje kryesore mund te permendim vleresimin e kerkeses per uje, zgjidhjen teknike per zonen e projektit, hapjen e dy puseve te reja, njerin ne afersi te pusit egzistues dhe tjetri rreth 140m nga pusi ekzistues afer lumit Gjader, ndertimin e stacionit te pompave te ri ne afersi te puseve, ndertimin e nje rezervuari me kapacitet 150m³ dhe ndertimin e rrjetit te ri shperndares me tubacione HDPE me cilesi te larte, perdorimin i manikotave dhe rakorderive me elektrosaldim, ndertimin e kasetave te matesave te ujit individuale, ne te cilen do te instalohen matesat per cdo abonent familjar, ndertimin e pikave te kontrollit me saracineska me aks vertikal.




Fig.1 planimetria e pergjithshme e rrjetit te ujesjellesit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të identifikojë ndikimet e mundshme të projektit mbi mjedisin dhe të këshillojë mbi masat e lehtësimit mjedisor dhe planin e monitorimit gjate fazes se ndertimit te objektit ne fjale. Ky dokument siguron pajtueshmërinë me legjislacionin Shqiptar mbi VNM si dhe me politikat zhvillimore të Bashkise Lezhe.

Raporti i vlerësimit te ndikimit ne mjedis perfshin indentifikimin, saktesimin dhe vleresimin e drejtperdrejt dhe te tërthor te projektit ne mjedisin ku do te zbatohet, si dhe percaktimi i masave per te parandaluar dhe zbutur demtimet ne mjedis.

Ky vleresim i ndikimit ne mjedis do te paraqes nje informacion te shkurter te projektit qe do te realizohet, ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe investitori do te marre per zbatimin e kritereve te nevojshme per mbrotjen dhe menaxhimin sa me racional te mjedisit.

Theksojme se shume nga vleresimet e detajuara te ndikimeve te mjedisit mbeshteten ne informacionet inxhinierike qe duhet te merren parasysh. Vleresimi identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive edhe negative dhe percakton rezultate per secilen prej tyre. Vleresimi identifikon nese ndikimet jane mesatare te pranueshme, te rendesishme, te terthorte apo te drejperdrejta.

KREU I LEGJISLACIONI

1.1 Qëllimi dhe objektivat e VNM-së

Qëllimi i VNM-së është të vlerësojë ndikimet negative dhe pozitive të projektit si dhe të paraqesë masat që duhet të aplikojë kompania për reduktimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis dhe komunitet.

Objektivat e VNM-së

Objektivi kryesorë i raportit të VNM-së është që të përmbushë kërkesat e legjislacionit shqiptar, me qëllim që të kemi një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor.

Objektivat specifike të VNM-së janë:

- Të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e rëndësishme mjedisore nga zhvillimi i projektit
- Për të përcaktuar përpueshmërinë e projektit të propozuar me përdorimin e tokës dhe të vlerësojë kushtet lokale mjedisore
- Për të parë avantazhet nga zbatimi i këtij projekti
- Për të vlerësuar dhe zgjedhur alternativën më të mirë nga opsionet e mara në studim
- Të përfshijë planet e menaxhimit Mjedisorë dhe mekanizmat monitoruese gjatë fazave të zbatimit dhe funksionimit të projektit.

1.2 Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekti i propozuar. Ky raport i Vlerësimit të ndikimit në Mjedis është hartuar duke patur parasysh legjislacionin e shtetit shqiptar dhe të Komunitetit Europian, me akte juridike ligjore dhe nënligjore specifike që rregullojnë ushtrimin e aktivitetit të investimeve dhe gjithashtu aktet ligjore lidhur me mbrojtjen e mjedisit si më poshtë:

Përmbledhja e legjislacionit

- Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”
- Ligji Nr.10 431, datë 09.06.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”
- Ligji Nr.10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”
- Ligji Nr. 8094, datë 24.04.2003, “Për largimin publik të mbeturinave”
- Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
- Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Ligji Nr. 9108, datë 17.7. 2003, “Për Substancat dhe Preparatet Kimike”
- Ligji Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me: Ligjin Nr.9826, datë 1.11.2007
- Ligji Nr. 12/2015, datë 26.02.2015 për disa ndryshime në ligjin Nr 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

- Ligji Nr.81, datë 4.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”
- Ligji Nr. 9868, date 4.02.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”
- Ligji Nr.10006, datë 23.10.2008 ”Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” , i ndryshuar
- Ligji Nr 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”
- Ligji Nr.10266, datë 15.04.2010 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Ligji Nr.9425, datë 06.10.2005 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe"
- Ligji Nr.10 422, datë 26.05.2011 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në rreze të gjatë" për financimin afatgjatë të programit bashkëpunues për monitorimin e vlerësimin e transmetimit në rreze të gjatë të ndotësve të ajrit në Europë (EMEP)
- Ligji Nr.10 476, datë 3.11.2011 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët, për të pakësuar acidifikimin, eutrofikimin dhe ozonin në shtresën e poshtme të atmosferës"
- Ligji Nr.10 062 , datë 29.01.2009 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin "Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare " të konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"
- Ligji Nr.9548 , datë 01.06.2006 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e regjistrave të shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve
- Ligji Nr.10 063 , datë 29.01.2009 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin "Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30% " " të konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët"
- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005, “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve” i ndryshuar: VKM Nr. 579, datë 3.9.2014
- VKM Nr. 13, datë 13.01.2013, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”
- VKM Nr. 419, datë 25.06.2014, “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi tipi A, B dhe C”
- VKM Nr. 676, datë 20.12.2002, “Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror”
- VKM Nr. 177, datë 31.3.2005, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”
- VKM Nr.435 datë 12.09.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- VKM Nr. 247, datë 30.4.2014, “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”
- Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të Deklaratës Mjedisor”
- Udhëzim Nr. 3, datë 03.09.2009, “Për metodologjinë e vlerësimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”

- Vendim Nr. 371, date 11.6.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”
- VKM-së Nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”
- Vendim Nr. 352, datë 29.04.2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të"
- Vendim Nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"
- Vendim Nr,781, datë 14.11.2012 "Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lengëshme për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim mjetet e transportit ujor (detar,lumor dhe liqenor)
- Vendim Nr,248, datë 24.04.2003 "Për miratimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër dhe zbatimin e tyre"
- Vendim Nr,435, datë 12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- Vendim Nr,803, datë 04.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit"
- Vendim Nr,781, datë 14.11.2012 "Për cilësinë e disa lëndëve të djegëshme, të lengëshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorimin e mjeteve të transportit ujor (detar,lumor dhe liqenor)"
- Vendim Nr.123, datë 17.02.2011 "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis"
- Vendim Nr.587, datë 07.07.2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike"

Ligji Nr. 10 440, datë 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

- a) Një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b) Garantim i një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Sipas kreut II, neni 7 “Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis” i këtij ligji citojmë:

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.
2. Proçedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:
 - a) Proçesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis
 - b) Proçesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis

Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vëndit.

Në bazë të këtij ligji, neni 3 i tij, citojmë objektivat e mbrojtjes së mjedisit.

- a. parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d. përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;

- e. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f. mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit

1.3 Klasifikimi i projektit

Përmbledhje e shkurtër e tipareve të projektit/veprimtarisë dhe vendndodhjes së tij duke treguar nevojën për të bërë vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, date 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit ne mjedis", Neni 8: Projektet qe i nënshtrohen procedurës paraprake te vlerësimit te ndikimit ne mjedis), Shtojca II ; : Pika 10 : Prodhime infrastrukturore, pika g) Instalime të kanaleve ujësjellës, dhe ligjit nr.12/2015 Per disa ndryshime ne ligjin (e sipercituar) nr.10440 datë 07.07.2011.

Klasifikimi i projektit ose veprimtarisë:

<i>VNM e thelluar</i>	
<i>VNM paraprake</i>	X
<i>Nuk ka nevojë për VNM</i>	

Projekti kërkon VNM PARAPRAKE, sepse projekti nuk zhvillohet në zonë të mbrojtur që kërkojnë leje mjedisore nga autoritetet përkatëse dhe nuk kemi të bëjmë me aktivitete që shkaktojnë dëmtim të pakthyeshëm të shëndetit të njerëzve, ekosistemeve, florës, faunës, shterime të përhershme të rrjedhjeve ujore, etj.

Qellimi kryesor është furnizimi me 24 ore uje i fshatit Dajc, Njësia Administrative Dajc, Bashkia Lezhe, duke realizuar vlerësim të përgjithshëm të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore të projektit me synim parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

KREU II PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 Qëllimi i projektit të propozuar.

Qëllimi i projektit është furnizimi me 24 ore në ditë me ujë të pijshëm i fshatit Dajç, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhe.

Për këtë do të ndërtohet rrjeti ujësjetës i ri i cili do të kalojë në gjurmën e ujësjetës egzistues.

Menaxhim i përmirësuar i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm të kësaj njësie; Furnizimi për 24 orë të gjithë banorëve të kësaj zone; Ngritja e një strategjie të qartë mbi ujin, kufjtë dhe përgjegjësitë për menaxhimin e tij të cilat do të çojnë në një planifikim më efektiv dhe në gjenerim të ardhurash për bashkinë; Nxitja e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme bujqësore dhe blegtorale përmes përdorimit të disiplinuar të ujit.

2.2 Skica dhe planimetri të objekteve dhe strukturave të projektit, mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit

Gjendja egzistuese



Zgjidhja Teknike e Projektit

Uji qe furnizon fshatin Dajc do te merret nga pusët me ane te pompave zhytëse, te cilat do e dergojne ujin tek stacioni i pompimit. Nga stacioni i pompimit linja per ne depon 150m³ do te jete me nje tubacion PE100 PN10 Dj90mm.

Do te rikonstruktohet komplet rrjeti i ujesjellsit Dajc. Tubacionet do te jene polietileni me desitet te larte, HDPE 100, Pn 10 bar.

Do te vendosen kaseta me matesave individual, ne te cilat do te instalohen matesat per cdo abonent familjar.

Do te ndertohet rrjeti komplet i ri, per lidhjet e familiareve, nga puseta e matesave deri te kufiri i prones te sejcilit abonent. Tubacionet e rrjetit familjar do te jene polietileni HDPE 100, Dn 20 Pn 10.

Furnizimi i konsumatoreve me uje, do te jete ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me kriteret minimale te meposhteme :

Furnizim me uje do te jete 24 ore me presion te mjaftueshem , cilesi te ujit ne perputhje me standartet Shqiptare.

Presioni i ujit te cdo abonent familjar do te jete jo me i vogel se 2 bar dhe jo me i madh se 6 bar.

Sistemi eshte projektuar bazuar ne Standardin EN 805 “Kerkesat per sistemet dhe perberesit jashte godines“.

2.3 Pëshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit

2.3.1 Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin.

Për ndërtimin e objekteve do të përdoret struktura beton/arme dhe gurë, të cilat do të sigurohen pjesërisht me materialin e gurit që del nga gërmimet dhe një pjesë e inerteve do të merren në pikat më të afërta me zonën, ku do të ndërtohet ujesjellesi. Karburanti do te furnizohet nga subjekte të licencuara për import, ruajtje dhe tregtim të karburanteve në Republikën e Shqipërisë, ndërsa për mbrojtjen nga pluhuri, për nevoja vetiake dhe nga punonjesit, mbrojtjen nga zjarri dhe shërbime të tjera do të përdoret ujë. Uji që do të përdoret për përgatitjen e betonit dhe përdorimet e tjera është i bollshëm dhe gjendet në afërsi të nënobjekteve. Për pije do të sigurohet nga burimet, ku sigurohet dhe nga banorët e fshatrave, ku do të zhvillohet projekti.

– Tubat e polietilenit

Tubat do të jenë polietilen me desitet te larte, HDPE, per furnizim nentokesor me uje, në përputhje me EN 12201, EN DIN 8074, EN DIN 8075. Te gjithë tubat do te jene prodhuar nga material origjinal dhe jo me material te ricikluar. Karakteristikat e tubave do te jene: per HDPE 100 – Pn 10 SDR 17, per HDPE 100- Pn 16 SDR 11. Tubat duhet te shenohen lexueshem si ne vijim: Fabrika, numuri i regjistrimit, standarti per uje te pijshem, materiali sipas specifikimeve. Presioni nominal, dimesioni, Klasa (toleranca e diametrit OD), data e prodhimit, seria, numuri makinerise. Tubat qe nuk do te shenohen si me sipër do te refuzohen. Tubat ne cdo kamion ngarkese do te shoqerohen me: Certifikaten e testit te materialit baze. Certifikaten e testit te

tubit. Udhezimet e prodhuesit. Udhezimet e prodhuesit te tubove do të ndiqen në mënyrë rigoroze gjate ngjitjes.

Ngjitja e tubave te polietilenit do te behet me metoden e elektrofuzionit. Gjate procesit te ngjitjes do te zbatohen te gjitha kushtet teknike te ngjitjes me elektrofuzion. Tubit qe ngjitet duhet ti hiqet shtresa e siperme qe mund te jete e oksiduar, pasi eshte matur manikota elektrofuzive dhe eshte shenuar tubi me lapesin me gjurme te pashlyeshme ne pjesen qe do te pastrohet. Pastrimi i siperfaqes se tubit do te behet me thiken e posacme te pastrimit dhe pas kesaj tubi dhe manikota ne pjesen e ngjitjes pastrohen me alkol me gradacion te larte qe te avulloje shpejt. Pastrimi behet me leter te bardhe te lagur me alkol. Gjate ngjitjes tubat duhet te jene rigorozisht ne te njejtin aks dhe nuk duhet te levizin pa u kaluar koha ftohjes. Ne fund ne pjesen e ngjitjes ne tub shenohen koha e ngjitjes, koha e ftohjes, sigla e personit qe ka bere ngjitjen. Pas kesaj tubi mbulohet me rere me trashesi 10 cm dhe ngjishet me makineri ose me krah dhe vetem pas kesaj behet mbulimi i tubit me dheun e dale nga germimi.

– **Dezinfektimi i tubave**

Të gjithë tubacionet duhet të dezinfektohet para se të vihen në shërbim, siç është urdhëruar nga inxhinieri. Dezinfektimit do të kryhet duke përdorur klor. Para dezinfektimit te tubacionit duhet të behet shlarja me ujë të pastër që rrjedh në një shpejtësi prej rreth 2 metër për sekondë. Klorizimit e tubove do të bëhet duke futur një sasi klori në një përqendrim prej rreth 25mg / l në tubacion në mënyrë që një sasi klor mbetur prej jo më pak se 10mg / l mbetet në ujë pas 24 orëve të qëndruara në tubacione.

Si dezinfektant mund te perdoret hypochlorite kalciumit ose dezinfektant tjetere. Pas dezinfektimit, tubacionet duhet të shpelahen me uje te pijshëm te pastër deri sa uji i perdorur per desinfektim, te zevendesohet. Uji përdoret qe perdoret për dezinfektim, nuk do të përdoret për qëllime të furnizimit me ujë.

– **Germimi kanaleve**

Punimet e germimit te kanaleve te tubacioneve, do te behen me makineri apo me krah, sipas rastit dhe sipas metodes se germimit qe do te paraqese ndertuesi dhe do te miratoje inxhinjeri. Para fillimit të çdo germimi Kontraktuori duhet të kontaktoje furnizuesit lokalë mbi vendndodhjen e tubacioneve dhe kablllove ekzistuese. Ku kabllot ekzistuese dhe tubat nderptiten me kanalet ose kalojne paralel me to, Kontraktori duhet gërmoje me krahe. Kabllot dhe tubacionet, të cilat janë paralel me kanalet e tubave qe do te vendosen, duhet te sigurohen qe te mos demtohen gjate punimeve te ndertimit. Kontraktori do të lejohen të përdorin eksplozivët vetëm me lejen e inxhinierit dhe punëdhënësit. Kanalet do te gërmohen siç specifikohet në standardet DIN 4124. Kanali i tubacionit do te jete i pershtatur me profilin. Gjerësia e poshtme të kanalit do të jetë sipas DIN EN 1610, siç kërkohet për diametër tub nominale. Thelësia e kanaleve do të jete sic tregohet në fletet perkatese te vizatimeve. Gjate germimit te kanaleve do te mbahet parasysh qe tubat te futen ne toke ne thellesine e projektit. Thellesia minimale e pjeses se siperme te tubit nga siperfaqja e tokes ne linjen kryesore te transmetimit do te jete 1 m. Thellesia minimale e pjeses se siperme te tubit nga siperfaqja e tokes ne linjen shperndarese te transmetimit do te jete 0.8 m. Kontraktori do të jetë përgjegjës për ndonjë dëmtim të kanaleve te hapura gjatë ditëve me shi në qoftë se ai nuk e ka plotësuar kushtet e mësipërme.

– Rimbushja e kanaleve

Pas vendosjes se tubit dhe shtreses se reres nen tub, tubi do te mbulohet me dhe me shtresa deri në 30 cm. Një shkallë e ngjeshje prej 95% është e nevojshme. Kontraktori do të kryejë testet sipas DIN 18134 për të verifikuar shkallen e specifikuar te ngjeshjes Pas përfundimit të punimeve, ne linjen ku kalojne tubacionet, duhet të vendoset një shirit paralajmërimi kabllor. Shiritido te tregojë vendodhjen e tubit dhe do te jete ne perputhje me DIN V 54841 - 1 do të vendoset gjate gjithë gjatësisese tubit, për të mbrojtur tubin dhe për të mundësuar një zbulim më vonë. Ngjyra dhe mbishkrim do të jenë sipas qëllimit. Shiriti paralajmërim do të jetë me ngjyrë intensive të shkëlqyer dhe 40 mm e gjerë. Guret me te mëdha se 25 cm diametër, dheu i tepert dhe materiale të tjera do të mblidhen dhe largohen nga objekti. Ne fund pasi mbaron i gjithë procesi i germimit dhe mbulimit te tubit, vendi kthehet ne gjendjen e mepareshme. I gjithë procesi para, gjate dhe pas punimeve fotografohet.

– Linjat e lidhjeve me shtepite

Nga pusetat e matesave dalin tubat qe lidhen me shtepite. Tubat jane HDPE 100 DN 20 Pn 10 Tubat do te te shtrihen nga pusetat e matesave te ujit, deri ne kufirin e prones se abonentit, gardhi qe rrethon shtepine. Tubat brenda oborit dhe baneses do te vendosen nga vete abonenti familjar. Tubat qe lidhen me shtepite do te futen ne thellesine jo me pak se 80 cm. Ne fillim rreth tubit do te vendoset dhe i seleksionuar i dale nga germimi i cili ngjishet dhe pastaj do te mbulohet, me dhe te dale nga germimi ne rastin e tubave qe kalojne ne fushe, kurse ne rastet e tubave qe kalojne ne rruge do te do te ndertohen shtresat rugore sipas faktit. Tubi do te mbulohet me dhe me shtresa deri në 30 cm. Një shkallë e ngjeshje prej 95% është e nevojshme. Kontraktori do të kryejë testet sipas. DIN 18134 për të verifikuar shkallen e specifikuar te ngjeshjes. Ne fund pasi mbaron i gjithë procesi largohen materialet e teperta te dale nga germimi dhe vendi kthehet ne gjendjen e mepareshme.

– Pusetat e ajrimit

Pusetat me valvolat e ajrimit do te instalohen ne linja, ne pikat me kuote me te larte. Brenda pusetave do te vendosen valvolat e ajrimit. Valvolat e ajrimit do te sherbejne per te nxjerre ne menyre automatike ajrin ne tubacione ne menyre qe te rregullohet performanca e levizjes se ujit ne tubacione. Permasat e pusetave ne te cilat do te montohen valvolat e ajrimit do te jene sipas fleteve te vizatimit. Pusetat do te jene b/a. Betoni sipas standartit EN 206-1. Klasat 12/15 dhe 20/25, Cimentoja sipas standartit EN 197-1, Hekuri sipas standartit DIN 488. Vetem soletat jane te armuara me hekur. Ne solete do te vendoset tubi i ajrimit te pusetes. Tubi i ajrimit te pusetes do te jene inoksi, te sigurojne mosfutjen e ujit te shiut dhe do te kete permasat e projektit. Dyshemese se pusetave do ti jepet pjeresi dhe do te vendoset nje tub shkarkimi HDPE 100 Dn 50 Gjatesia e tubit do te varrroje sipas terrenit ne menyre qe pusetat te mos mbajne uje ne rast te mosfunktionimit te valvolave te ajrimit. Valvolat e ajrimit do te jene sipas standartit DIN 86251 Tubat e gizes me fllanxhe ne te dy anet do te jene sipas standartit DIN 28614, saracineskat sipas standartit DIN EN 1171 PN 16 bar, Kapaku i pusetave do te jete sipas standartit EN 124 Grupi 4 D 400 per pusetat qe vendosen ne rruge dhe EN 124 Klasa A 15 per pusetat jashte rruge. Diametri i kapakut do te jete Dn 600 mm. Pasi pusetat te jene betonuar dhe para se te mbulohen me dhe do te lyhen me dy duar bitum. Shkallet e pusetave do te jene sipas standartit EN 13101 A 400 shkalle te galvanizuara te veshura me plastike. Do

te vendosen tre shkalle cdo 35 cm duke filluar nga dyshemeja ashtu sic tregohet ne fletet e vizatimit.

– **Kalimet e perrenjve**

Ne kalimet e perrenjve tubi do te kaloje poshte shtratit te perroit. Tubi HDPE 100 do te futet ne tub celiku per ta mbrojtur tubin nga ndryshimet e temperaturave dhe demtimet mekanike. Ne pjesen e poshtme te tubit (sipas drejtimit te rrjedhes se ujit te perroit) do te ndertohet nje prite me mur guri me gabiona, nje rresht me permasa te gabioneve 100x100x100 dhe rreshti tjetër me permasa 100x100x50 cm paralele me tubin

– **Kalimi i rrugeve**

Kalimet e tubacioneve do te jene kryesisht anes rrugeve apo ne rruge kur nuk ka mundesi tjetër, per te shmangur kalimin e linjave ne prona private. Ne rastet kur do te kemi intersektime te linjes qe do te ndertohet me rruget ekzistuese, per te mbrojtur tubin, kalimi do te realizohet duke futur tubin HDPE 100 ne tub celiku. Vendndodhja e kablllove elektrike, te telefonise, te fibrave optike eshte sqaruar me Autoritetet Lokale. Pas vendosjes se tubit, do te mbulohet me dhe, me shtresa deri në 30 cm. Një shkallë e ngjeshje prej 95% është e nevojshme. Kontraktori do të kryejë testet sipas DIN 18134 për të verifikuar shkallen e specifikuar te ngjeshjes Pas përfundimit të punimeve, ne linjen ku kalojne tubacionet, duhet të vendoset një shirit paralajmërimi kabllor. Shiriti do te tregojë vendodhjen e tubit dhe do te jete ne perputhje me DIN V 54841 -1 do të vendoset gjate gjithe gjatësisë se tubit, për të mbrojtur tubin dhe për të mundësuar një zbulim më vonë. Ngjyra dhe mbishkrim do të jenë sipas qëllimit. Shiriti paralajmërim do të jetë me ngjyrë intensive të shkëlqyer dhe 40 mm e gjerë. Shtresat e rruges do te ndertohen sipas faktit. Guret me te mëdha se 25 cm diametër, dheu i tepert dhe materiale të tjera do të mblidhen dhe largohen nga objekti. Ne fund pasi mbaron i gjithe procesi i germimit dhe mbulimit te tubit, vendi kthehet ne gjendjen e mepareshme. I gjithe procesi para, gjate dhe pas punimeve fotografohet.

KREU III

PËRSHKRIMI FIZIK DHE BIOLOGJIK I ZONËS

3.1 Mjedisi fizik

Bashkia Lezha kufizohet në veri me Bashkitë e Vaut të Dejës dhe Pukës, në perëndim me Detin Adriatik, në lindje me Bashkinë e Mirditës dhe në jug me Bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Lezhës.

Sipas Censurit të vitit 2011, Lezha ka 65,633 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 106,245 banorë. Me një sipërfaqe prej 509.1 km², bashkia e re e Lezhës ka një densitet prej 208.69 banorë/km² sipas të dhënave të Regjistrit Civil dhe 128.91 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 10 njësi administrative, të cilat janë: Lezha, Shëngjini, Zejmeni, Shënkolli, Balldreni, Kallmeti, Blinishti, Dajçi, Ungreji dhe Kolshi. Të gjitha këto njësi janë aktualisht pjesë e rrethit të Lezhës dhe e po të njëjtit qark. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Lezhë dhe Shëngjin) dhe 65 fshatra.

Bashkia e Lezhës shtrihet në pjesën dërrmuese të vet në një zonë të ulët dhe bregdetare, me lartësi 5 metra mbi nivelin e detit. Trashëgimia e pasur historike dhe kulturore e bën këtë bashki një destinacion tërheqës për turizmin kulturor.

E shtrirë në të dy anët e lumit Drin, e rrethuar nga lagunat Kunë e Vain si dhe nga plazhi i bukur i Shëngjinit, Lezha ofron bukuri natyrore të larmishme dhe mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit jo vetëm brenda territorit të saj, por edhe në një distancë të afërt.

Aktualisht, ekonomia në qytet është e diversifikuar, por mbështetet në tregti dhe shërbime, sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve të Lezhës. Ndërtimi i Parkut të Biznesit në pjesën veriore të qytetit pritet të nxisë përqendrimin e bizneseve vendore dhe rajonale në këtë qytet.

Vitet e fundit, industria e përpunimit të peshkut në rajonin e Lezhës ka njohur investimet më të mëdha në rang vendi, sa i përket ngritjes së stabilimenteve të peshkut.

Pozicioni i favorshëm gjeografik mundëson akses në të mirat bujqësore, të agrikulturës, blegtorisë dhe peshkimit, të cilat ndikojnë gjithashtu në potencialin ekonomik dhe rritjen e punësimit në Bashki. Megjithatë, një pjesë e territorit të Lezhës vazhdon të kërcënohet nga përmytjet, të cilat shkaktojnë herë pas here dëme të konsiderueshme.

Bashkia e re do të ketë në territorin e saj qytetin e Shëngjinit dhe një vijë të gjatë bregdetare, e cila fillon nga rezervatet natyrore të mbrojtura të Bregut të Matit dhe të Kune-Vain-Tales deri te plazhet shkëmbore në veri të qytetit të Shëngjinit. Një pjesë e mirë e bregdetit nuk i ka shpëtuar betonizimit, ndërsa në këtë vijë bregdetare ka ende plazhe të virgjëra, të cilët duhen mbrojtur.

Zona etnografike e Zadrimës, e cila shtrihet në pjesën veriore të bashkisë së re është një pasuri e cila së fundmi po kthehet në atraksion të agro-turizmit dhe të ushqimit të ngadaltë.

3.2 Mjedisi biologjik

3.2.1 Flora

FLORA DHE FAUNA

Flora dhe fauna në Qarkun e Lezhës karakterizohet nga një shumëllojshmëri. Kështu flora dallohet për kultivimin e shumë bimeve mjekësore dhe etero-vajore si: rozmarine, trendafil i eger, dellenje, shtogu, sherebel, brumez, levanto, frasher, gjineshtra, etj.

Nga pyjet, te cilet zene nje siperfaqe te konsiderueshme permendim pyjet e ulta dhe shkurret.

Metodologjia e përdorur për vlerësimin e përgjithshëm botanik është kryer sipas dy etapave, nëpërmjet konsultimit me literaturën vendase dhe të huaj dhe ekspeditës në terren, për grumbullimin e materialit bimor.

Përcaktimi i specieve është kryer sipas çelësave të përcaktimit, të tillë si: “Flora e Shqipërisë” (Paparisto et al., 1988-2000), “Flora ekskursioniste e Shqipërisë” (Demiri, 1983), “Flora Europea” (Tuttin et. al, 1964 - 1980), “Udhëheqës fushor i florës së Shqipërisë” (Vangjeli, 2003).

Speciet e identifikuar janë listuar në tabelën floristike, ku janë organizuar të dhënat për:

- Emri latinisht (emrat janë përcaktuar sipas bazës së të dhënave Euro+Med plant database)
- Emri shqip (janë nxjerrë nga florat shqipëtare)
- Familja
- Forma Biologjike (sistemi Raunkier)
- Forma Korologjike
- Antropotoleranca sipas (Ettig, 1985)
- Statusi sipas Listës së Kuqe të florës dhe faunës së Shqipërisë (grup autorësh 2013)

Përcaktimi i formës biologjike është kryer sipas sistemit Raunkier,

1 Ph-Fanerofite, janë ato specie, të cilat nxjerrin sythet e tyre mbi 25 cm nga sipërfaqja e tokës.

2 Kamefitet, kane sythat të vendosur në lartësi të vogël nga toka (më pak se 25 cm), në mënyrë të tillë që të përdorin për mbrojtje bimësinë përreth, mbeturinat bimore apo dëborën.

3 Hemikriptofitet, janë bimë barishtore, të cilët i kanë sythat të vendosur në apo më lart se sipërfaqja e tokës. Mbrohen nga mbeturinat bimore shpesh nga gjethet e tyre të vdekura, ose nga dëborat. Shumica ruajnë një rozetë të gjelbër gjethesh gjatë dimrit. Bëjnë pjesë shumica e gramoreve.

4 Kriptofitet, kanë sythat të futur në tokë ose të zhytura në ujë dhe dallojmë:

- a) Geofitet, të cilat kanë sythe që ndodhen nën sipërfaqen e tokës dhe ku përfshihen të gjitha bimët me bulb apo qepë, rizomë, zhardhokë të tilla si zambakët apo patatja etj.
- b) Helofitet, bimë me rizomë të zhytur në ujë.
- c) Hidrofitet, ose bimët ujore të vërteta që janë notuese ose të rrënjëzuara në ujë dhe me sythe brenda ujërave.

5 Terofitet, janë bimë njëvjeçare barishtore që kalojnë stinën e dimrit në gjendje fare. Përgjithësisht në këtë grup bëjnë pjesë llojet njëvjeçare.

Antropotoleranca është indikator i përhapjes gjeografike të bimëve sipas tolerancës ndaj ndikimit antropogjen. Ky parametër është përcaktuar kryesisht nga literatura bazë (Wittig, 1985; Mesiti & Dinga 2015, 2016; Buccheri & Martini, 2015; Stešević et. al., 2014). Sipas këtij parametri bimët ndahen në:

- a) Specie urbanofobe. Specie që rriten larg ndaj ndikimit urban.

b) Specie urbanoneutrale. Janë ato bimë që rriten në habitate të ndryshme, pavarësisht pranisë ose jo të ndikimit antropogjen

c) Specie urbanofile. Janë speciet që rriten kryesisht në vende me një intensitet të lartë urban.

Aspekti faunistic është i lidhur ngushtë me mjedisin rrethues. Ai paraqet një larmi biologjike mjaftë të evarfer që është po kështu një pasqyrim i gjendjes së këtij ekosistemi industrial minerar dhe të afënjësive të kodrave të Katjelit.

3.3.2 Fauna

Në gjithë territorin rriten kafshë të buta dhe të egra. Nga kafshët e buta përmendim rritjen dhe mbareshtimin e gjedheve, dheneve, derrave, kuajve, shpendeve. Teper e zhvilluar është edhe rritja e bleteve, e përhapur në zona të veçanta. Nga kafshët e egra rriten dhelpra, ujku, kunadhja, ariu, derri, macja e eger, vjerdulla, nuselala, baldosa, ketri, thellenxa, kaprolli.

3.4 Popullsia

Sipas Censurit të vitit 2011, Lezha ka 65,633 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 106,245 banorë. Me një sipërfaqe prej 509.1 km², bashkia e re e Lezhës ka një densitet prej 208.69 banorë/km² sipas të dhënave të Regjistrimit Civil dhe 128.91 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 10 njësi administrative, të cilat janë: Lezha, Shëngjini, Zejmeni, Shënkoll, Balldrëni, Kallmeti, Blinishti, Dajçi, Ungreji dhe Kolshi. Të gjitha këto njësi janë aktualisht pjesë e rrethit të Lezhës dhe e po të njëjtit qark. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Lezhë dhe Shëngjin) dhe 65 fshatra.

Bashkia Lezhë

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Lezhë	Qyteti Lezhë	Lezhë	Qyteti Lezhë	65,633	106,245	509
		Shëngjin	Qyteti Shëngjin, Fshatrat; Ishull-Shëngjin, Ishull- Lezhe, Mali-Shëngjin, Mali- Rencit, Kodër Mulliri			
		Zejmen	Fshatrat; Zejmen, Tresh, Pruell, Berzane, Pllanë, Markatomaj, Spiten			
		Shënkoll	Fshatrat; Shënkoll, Rilë, Tale 1, Tale 2, Barbullojë, Grykë-Lumi, Gajush, Alk			
		Balldrën	Fshatrat; Balldrën, Mali-Kakariq, Qëndër-Kakariq, Gocaj, Balldrën i Ri, Torovicë, Malecajt, Koljakaj			
		Kallmet	Fshatrat; Kallmet i Madh, Kallmet i Vogel, Rraboshtë, Mërqi			
		Blinisht	Fshatrat; Blinisht, Troshan, Fishtë, Krajnë, Piraj, Baqel, Kodhel			
		Dajç	Fshatrat; Dajç, Gjadër, Gramsh, Mabë, Dragush, Kotërr, Zojs			
		Ungrej	Fshatrat; Ungrej, Kashnjet, Gjobardhaj, Kalivaç, Ras-Butë, Zinaj, Fregen, Kaluer, Sukaxhi			
		Kolsh	Fshatrat; Kolsh, Gjash, Kacinar, Patalej, Lalm, Lalm Lukaj, Velë, Manati, Grykë, Barbullojë e Re			

njesite administrative/fshatrat

3.5 Turizmi

Klima e përshtatshme dhe shumë e butë bën që Lezha gjatë tërë vitit të jetë vend dominant për pushime dhe turizëm. Numri i ditëve me diell në vite mbi 260 ditë, i orëve vjetore 2340, ose 6,5 orë në ditë. Kurse gjatë verës mbi 10 orë në ditë, duke dominuar zonën në Adriatik. Klima është tipike mesdhetare me verë të thatë e të nxehtë dhe dimër të butë. Nga deti fryn era e freskët duke freskuar ditët e gjata të verës me temperatura mbi 25 gradë. Të gjitha kushtet së bashku garantojnë një sezon për larje dhe marrje rreze dielli deri në 6 muaj nga muaji Maj deri në fund të Tetorit. Në lezhë vihet për diell, det, plazhe të rërës, bukuri të natyrës dhe për vendas mikpritës e të shoqërueshëm. Me fillimin e sezonit zona e bregdetit merr një jetë të re, duke u dhjetëfishuar numri i banorëve. Pjesa më e madhe e këtyre vizitorëve vijnë nga Shkodra, Tirana, Laçi, Mirdita, Kukësi, kruja, Burreli, dibra dhe këto dy vitet e fundit edhe nga Kosova dhe Mqedonia. Bregdeti i lezhës frekuentohet nga pushuesit edhe si vend i qetë dhe i sigurt. Në gjithë vijën e bregdetit do të gjeni një panoramë të pasur me pyje dhe me lagunat e veçanta shoqëruar me florën dhe faunën e pasur si dhe do të vëzhgoni traditat e kësaj zone në gjueti dhe në peshkim. E veçanta e këtij plazhi është rëra e pasur me jod dhe që është vlerësuar si rëra më kurative në bregdetin e Adriatikut. Rripi i gjerë i rërës së pastër është i kufizuar nga njëra anë me detin ndërsa nga ana tjetër me pyllin, ku kryesisht rriten pishat, por nuk mungojnë edhe lloje të tjera drurësh të kultivuar.

3.6 Ekonomia

Lezha është një qendër e rëndësishme ekonomiko-industriale në Shqipëri. Për tu përmendur janë industria e peshkimit shumë e zhvilluar në zonën bregdetare të Shëngjinit. Ekonomia e qytetit bazohet më shumë në turizmin e saj.

Ne rrethin e Lezhes cdo vit rriten shume lloje bimesh mjeksore. Me rendesi eshte sherebela. Prodhimi mesatar vjetor arrin ne rreht 2000 ton. Sherebela e mbledhur ne kete rreth eshte me e kerkuara ne treg.

3.7 Burimet ujore

Lezha me zonat përreth është një ndër rajonet e Shqipërisë më të pasura me ujra. Kjo pasuri ujore e saj përbëhet kryesisht nga ujrata e detit Adriatik që lagin brigjet e këtyre zonave, ato të rrjetit hidrografik, ujrata e lagunave në të dy anët e grykëderdhjes në det të lumit Drin i Lezhës dhe ujrata nëntokësore të fushës së Lezhës. Lezha dhe zonat përreth janë të pasura gjithashtu me reshje atmosferike të bollshme të cilat janë kryesisht rreshje shiu dhe shumë rrallë rreshje bore. Sasia mesatare vjetore e tyre është 1460 mm në vit. Rreshjet maksimale ditore të matura janë 160 mm në 24 orë. Numri i ditëve me reshje është 120 ditë në vit.

Rrjedhjet ujore më të rëndësishme që formojnë këtë rrjet hidrografik janë lumi Drin i Lezhës dhe lumi Gjadër. Lumi Drin ka qenë elementi kryesor i sistemit dhe i rrjetit hidrografik të Lezhës dhe i zonave përreth. Vetë ky sistem hidrografik në një shkallë të konsiderueshme është rrjedhojë e veprimtarisë dhe e prurjeve të ngurta që lumi Drin ka përcjellë në shekuj në detin Adriatik. Por sot, ky lumë nuk kalon më në shtratin e tij shekullor, përbri qytetit të Lezhës. Ai nuk i derdh më ujrata e tij në det, por në lumin Buna. Është ndofta rast shumë i rrallë, për të mos thënë unikal, që një lumë kaq i madh me ndërhyrjen e ndërjegjshme edhe të vetë njerëzve,

ndryshon tërësisht rrjedhën e tij. Lumi Drin është lumi më i madh i Shqipërisë dhe i dyti për sa i përket ujshmërisë, mbas lumit Buna. Ai është lumi më i madh në tërë bregdetin Adriatik të gadishullit Ballkanik.

3.8 Pyjet

Lezha shtrihet në pjesën perëndimore të Shqipërisë, në jug të fushës së Shkodrës. Nga ana gjeografike është një vend i favorshëm për rrugën që lidh perëndimin me lindjen e rajoneve shqipfolëse. Në një largësi prej 300 km është një lidhëse e Prishtinës me rajonet jugore të Shqipërisë. Ajo ka pozitive gjeografike të favorshme, prandaj edhe venedikasit, 600 vjet më parë, e quajtën “syri i djathtë i Durrësit”, me një sipërfaqe prej 473 km², tregues ky që e rendit Lezhën ndër rrethet e vogla të Shqipërisë, me një vijë kufitare prej 181 km, nga e cila 124 km kufi tokësor, 27.5 km kufi detar dhe 29.5 km kufi lumor. Gjatesia më e madhe e rrethit të Lezhës, nga veriu në jug, është 30 km dhe nga perëndimi në lindje 27 km.

Relievi i Lezhës paraqitet në dy pamje: Krahina Malore Qendrore, ku futen zonat Kashnjë, Kreshtë, Mali i Veles, Malesia e Lezhës, deri në jug, Kodrat e Pllanës dhe Ultesira Perëndimore, ku përfshihet gjithë pjesa tjetër, fusha dhe tokat e lagura (pothuaj në raporte të barabarta). Ndryshe nga relievi i vendit, ai i Lezhës paraqet një pamje me sipërfaqe në nivelin e detit (Kënetat Knallë e Kakarriq), fusha me lartësi 0 – 10 m mbi nivelin e detit dhe male me lartësi mbi 1000 m. Ky reliev, prania në të e zonave të lagëta (ligatinave), fushave e malit, tokave të pasura dhe klimës mesdhetare, ka kushtëzuar vegjetimin e një flore të pasur pyjore, që me shifra mund të shprehet: afro 80 % e specieve të vendit (3250 specie). Speciet e drurëve pyjore janë të përhapura në formën e shoqërimeve pyjore. Përveç specieve që rriten rastësisht (spontaneisht), nepermjet pyllëzimeve janë instaluar lloje me rritje të shpejtë, si Pisha e detit (*Pinus pinaster*), Pisha e bute (*Pinus pinea*), Pisha e eger (*Pinus halepensis*) etj

KREU IV

VLERËSIMI I NDIKIMEVE DHE NEGATIVE NGA ZBATIMI I PROJEKTIT DHE MASAT ZBUTËSE

4.1 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis

Veprimtaria që propozohet të kryhet nuk ka përmasa relativisht të mëdha, qoftë të karakterit të investimeve ashtu edhe të outputeve që do të japë gjatë shfrytëzimit të saj. Ky investim do të mundësojë furnizimin 24 ore me uje te fshatit ku do te zhvillohet projekti. Ky kapitull i vlerësimit të ndikimeve në mjedis do të paraqesë një analizë të hollësishme të ndikimeve të mundshme negative dhe positive duke specifikuar edhe masat zbutëse që duhet të aplikohen për të eliminuar apo për të minimizuar sado pak ndikimet në mjedis.

Kjo analizë kryhet duke u bazuar në projektin e konceptuar të diskutuar si më lart në këtë raport, identifikimi i pasurisë natyrore të rajonit dhe përmasave të projektit. Ndikimet në mjedis mund të ndodhin si gjatë ndërtimit, ku ndikimi në rastin konkret është me potencial gjatë punimeve të ndërtimit, ashtu edhe gjatë shfrytëzimit të këtij aktiviteti.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë, bëhet duke u nisur nga një serë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e ujit te perdorur, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjeneruara, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Ndikimet mund të grupohen si më poshtë:

- Kimike-Fizike, të cilat lidhen me ndikimet mbi burimet natyrore si dhe proceset e degradimit fizik të mjedisit vetë.
- Biologjike-Ekologjike përfshirë burimet e energjive të rinovueshme, ruajtjen e biodiversitetit, ndikimin mbi jetën e gjallë të ndotjes së biosferës
- Sociologjike të lidhura me komunitetin apo edhe individët e veçantë, ndikimin mbi trashëgiminë kulturore dhe progresin e supozuar.
- Ekonomike-Makroekonomike, të cilat marrin parasysh ndikimet e përkohshme apo të përhershme shkaktuar për shkak të realizimit të projektit

Shfrytëzimi i burimeve ujore për ujesjelles kërkon përdorimin e teknologjive për ndërtimin e veprës së marrjes, pusteua komadnimi, shtrirjen e tubacionit, depo, etj. Kështu mund të themi se ndikimet më thelbësore mund dhe duhet të analizohen sipas fazave të veprimtarisë dhe konkretisht:

- Faza përgatitore, e cila lidhet me sistemimin e vendit ku do të ndërtohet
- Faza e shfrytëzimit, e cila lidhet me operimin e ujesjellesit
- Faza përfundimtare, e cila lidhet me rehabilitimin e ujesjellesit pas 25 vitesh.

E rëndësishme është të kuptohet dhe të qartësohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve:

- Të kthyeshme në mjedis
- Të pakthyeshme në mjedis

Gjithashtu vërejmë se të dyja llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative, ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizimin e proceseve të natyrës dhe rigjenerimit të ekosistemit.

4.1.1 Metoda e identifikimit të ndikimeve negative

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis nga projekti u ndoqën hapat e mëposhtme:

- Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij, mënyra e propozuar për shfrytëzim, makineritë, etj.
- Njohja me infrastrukturën ekzistuese të trashëguar të zonës, ku do të ndërtohet ujesjellesi dhe nevojën për infrastrukturë të re për projektin.
- Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe të sipërfaqes.
- Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis (gërmime, ndërtime, etj.)
- Konsultimi me shumë dokumenta e raporte të VNM-ve, për veprimtari të njejta.

Sa më sipër vlerësimi i ndikimeve në mjedis do të vlerësojë:

- Ndikimet në ajër
- Ndikimet në ujëra
- Ndikimet në tokë
- Ndikimet në biodiversitet (mjedisi biologjik)

4.2 Ndikimi në ajër (cilësia e ajrit, vibrimet)

Impakti nga ndërtimi: Gjatë fazave të ndërtimit të ujesjellesit dhe gërmimeve mund të ketë emetim pluhurash dhe ky ndikim negativ në cilësinë e ajrit do të jetë i përkohshëm. Gazet e dëmshme të çliruara nga djegia e karburantit të automjeteve dhe pluhurat mund të krijohen gjatë fazës së ndërtimit të ujesjellesit, por gjithnjë pa i kaluar limitet e lejuara, ndërkohë që gjatë shfrytëzimit të ujesjellesit nuk do të ketë emetime gazesh të dëmshme pas shperndarja do te behete me gravitet pra rrejdhje te lire.

Impaktet gjatë funksionimit: Ndërkohë që gjatë shfrytëzimit të ujesjellesit nuk do të ketë emetime gazesh të dëmshme pasi nuk do te perdoren lende fosile per venien ne pune te ujesjelelsit. Kjo padyshim paraqet një ndikim pozitiv ne mjedis të te ujesjellesave me gravitet (rrjedhje te lire)

Masat parandaluese: Aplikimi i lagies së trasesë dhe kantierit me ujë gjatë sezonit me thatësi të për të reduktuar pluhurat. Kufizimi i orarit gjatë ditës për të reduktuar zhurmat. Përdorimi i mjeteve bashkohore. Përdorimi i mjeteve dhe materialeve cilësore e eficiente. Monitorimi i cilësisë së ajrit gjatë fazës së punimeve.

4.3 Ndikimet në ujëra (ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore)

Impakti nga ndërtimi: Nga zbatimi i këtij projekti ndikimet në ujëra do të jenë prezente. Ndikimi në ujërat sipërfaqësore do të vijë, si rrjedhojë e kryerjes së punimeve të ndërtimit të veprës së marrjes, të cilat do të kryehen në burim. Gjithashtu gjatë hapjes së trasesë së kanalit te ujesjellesit do te kete ndikime ne mjedis, po ashtue edhe rritjen e lëndës së ngurtë në pezulli. Për rrjedhojë, ky ndikim mund të pasqyrohet edhe në mjedisin uxor pritës, ku derdhet ky përuea. Ndikim në ujërat nëntokësore nuk vlerësohet të ketë pasi punimet do të jenë në sipërfaqe, rreth 1-2 m thellësi nën sipërfaqe.

Impakti gjatë funksionimit: Realizimi i projektit për ndërtimin e ujesjellesit nuk do të ndikojë në regjimin e ujrave të lumit. Ujërat e shirave që bien, duke u bashkuar dhe me ujërat sipërfaqësore të degëve përbërëse të tjerë më të vegjël, ushqejnë rrjedhjen në segmentin e përrenjve, që ndikohen nga ndërtimi i ujesjellesit.

Nuk do të ketë ndikim domethënës në ujërat nëntokësore, sepse nuk do të krijohen basene të mëdhenj ujore për rregullimin e regjimit të prurjeve.

Masat parandaluese: Gjatë punimeve ndërtimore, subjekti do të zbatojë kushtet teknike të zhvillimit të punimeve, të ndërtojë prita për inertet e gërmuara dhe të fillojë rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara me bimësi autoktone dhe me system rrënjor të fortë, mbjellja e barit antieroziv, sistemimi dhe sheshimi i sipërfaqeve me dhe, humus të nxjerrë nga punimet që në fazën e hershme, si dhe largimi i pirgjeve me material toke të grumbulluara, paralelisht. Të punohet gjatë sezonit të thatë, ku rrjedha e përroit mund të meaxhohet gjatë kryerjes së punimeve.

4.4 Ndikimet në tokë

Impakti nga ndërtimi: Nga zbatimi i këtij projekti ndikimet në tokë do të jenë jo të vogla, ndërtimi i këtij ujesjellesi kërkon një hapësirë relativisht të vogël në tokë pasi tubacioni do të shtrihet në gjurmen egzistuese të kanalit dhe në disa pjese do të hapen gjurme të reja, dhe veprat do të ndërtohen në gjurmen egzistuese. Drop e re që do të ndërtohet është parashikuar në toke të qendrueshme. Përdorimi i tokës konsiston edhe në zënien e saj ndonëse në sipërfaqe të vogla për depozitimin e përkohshëm të shtresës së humusit dhe ndërtimin e përkohshëm të kantierit të ndërtimit. Në lidhje me efektin e erozionit për skarpatet e trasesë së kanalit vëmë në dukje se projekti do të ketë ndikim jo shumë të madh. Objektet e veprës do të montohen në mjedis të qëndrueshme, ku ky efekt është minimal, ndikimi i këtij procesi të ndërtimit është i lokalizuar dhe nuk do të ndikojë në terrene ku duket efekti i erozionit. Gjatë gërmimit për të ndërtuar veprat përbërëse do të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme efekti i erozionit dhe rrëshqitjes së tokës.

Impakti gjatë funksionimit: Ndikimi në tokë nga operimi dhe mirëmbajtja e ujesjellesit do të jetë në nivele të ulëta. Ndikim të operimit konsistojmë sipërfaqet e zëna për objekte me periudhe afatgjatë ose të përhershme. Në raste të avarive ose të dëmtimeve të rënda në kanalin e tubacionit do të duhen ndërhyrje në terren, ku mund të kemi një ndikim lokal dhe të përhershëm të përdorimit të tokës.

Masat parandaluese: Masat parandaluese do të ishin të nevojshme për reduktimin e impaktit mbi tokë të këtij projekti. Rekomandojmë ndërtimin e pritave me mure guri ose gardhe prej druri ose me rrjetë teli dhe bimësi autoktone. Rehabilitimi i sipërfaqeve sa më shpejt të jetë e mundur për të mos humbur sipërfaqe toke. Këto masa do të ishin të nevojshme për reduktimin e impaktit mbi tokë të këtij projekti.

4.5 Ndikimi në biodiversitet (flora dhe fauna tokësore dhe ajo ujore)

Impakti nga ndërtimi: Zona ku do të ndërtohet ujesjellesi ka një ekosistem të pasur dhe të formuar në aspektin biotik. Zbatimi i projektit dhe zhvillimi i tij nuk ndikojnë negativisht në mënyrë domethënëse në humbjen dhe dëmtimin e habitateve, si dhe të specieve bimore në zonat, ku ai ushtron aktivitetin e tij. Do të kryhen punime në zona me bimësi të pakët në formë dushqesh, shkoze dhe ambjentet, ku do të bëhen ndërtimet ujesjellesit do të pasurohen me rigjellbërime vendas, por edhe depot do harmonizohet me ndërtimet karakteristike të zonës, duke mos thyer pamjen vizive të peizazhit të zones. Nga projekti do të priten një sasi e vogël dushqesh dhe vegjetacioni ahu natyror gjatë ndërtimit të traseve të tubacionit. Këto janë kosto të pranueshme për projekte të tilla, që kanë si qëllim furnizimin e zonez me 24 ore ujë të pijshëm. Kompania zbatuese krahas zbatimit të projektit inxhinierik do të hartojë një plan

rehabilitimi të zonës së projektit, veçanërisht, aty ku toka i është nënshtruar punimeve të gjermimit.

Impakti gjatë funksionimit: Pas vënies në punë të ujesjellesit dhe gjatë funksionimit, nuk do të kete demtime në flore dhe faune. Por meqë kapaciteti i burimit do të perdoret me shume do të kemi një ndikim të vogël në mjedisin e habitateve në zonën e projektit, ky ndikim do të jetë minimal dhe me shume gjate muajve të thate të vitit.

Masa parandaluese: Rehabilitimi sa më parë i skarpateve dhe sipërfaqeve pyjore të dëmtuara dhe investimi në ndërtimin e pritave për reduktimin e erozionit. Zbatimi i projektit të rehabilitimit sipas preventivit të detajuar të punimeve rehabilituese dhe monitorimi i cilësisë së këtij procesi në vazhdimësi. Mirëmbajtje dhe monitorim të vazhdueshëm të terrenit problematik edhe nga erozioni natyror në segmente të caktuara. Mbjellja e bimësisë autoktone dhe sipas skemës së projektuar për të ndikuar ndjeshëm në uljen e erozionit dhe në ruajtjen e identitetit të bimësisë së zonës. Si rrjedhojë dhe rikthimin e faunës autoktone të larguar përkohësisht. Ruajtja e burimit ujor nga gjuetia e paligjshme e florës dhe faunës ujore dhe asaj tokësore.

4.6 Ndikimet në mjedisin social-ekonomik (mjedisi social-kulturor dhe ekonomik, përdorimit të tokës dhe burimeve ujore)

Impakti nga ndërtimi: Ndikimi në mjedisin social-kulturor e ekonomik nga faza e zbatimit të punimeve të ndërtimit, vlerësohet të jetë positive. Kjo për shkak të nivelit të ulët ekonomik të zonës dhe rritjes së punësimit nga aktiviteti ndërtimor. Investitori do të kryejë edhe disa punime të kërkuara nga komuniteti, si: mirëmbajtje rrugë për komunitetin, etj. Gjetja e objekteve arkeologjike gjatë punimeve do të ndryshojë rrjedhën e punimeve dhe nuk do të dëmtojë këto objekte, megjithëse nga institute përkatës nuk identifikohen të tilla. Investim i tillë ndikon në zhvillimin ekonomik e social-kulturor të zonës.

Impakti gjatë funksionimit: gjatë fazës së vënies në punë të Ujesjellesit gjithashtu do të ketë punësime nga banorët e zonës, do të mirëmbahen rrugët dhe ndonjë investim tjetër që mund të kërkohej nga komuniteti. Përsa i përket konfliktit të interesave të banorëve, ato nuk janë prezente. Uji që do të merret nuk perdoret për ndonjë nevojë të vecante.

Masa parandaluese: Plotësimi i kërkesave të komunitetit, plotësimi i nevojave edhe për blegtorinë, mirëmbajtje e rrugëve dhe rrypëllëzime e pylëzime të reja, hapja e vendeve të punës për komunitetin, etj.

4.7 Ndikimet që shkaktojnë ndryshimet klimatike (Ndryshimi i klimës, emetimi i substancave ozon-holluese)

Impakti nga ndërtimi: Aktiviteti ndërtimor nuk do të përfshijë substance të tilla që mund të ndikojnë në rritjen e përqendrimit të lëndëve ozon-holluese në atmosferë. Vlerësohet vetëm lënda djegëse e mjeteve të rënda të punimeve të gjermimit në nivele të ulëta.

Impakti gjatë funksionimit: Nga funksionimi i këtij iketij projekti ndikimi në substancat ozon-holluese është me efekt pozitiv, pasi redukton emetimin e këtyre substancave nëpërmjet eliminimit të përdorimit të energjisë dhe përdorimi i gravitetit të zonës.

Masa parandaluese: Nuk rekomandojmë masa parandaluese, pasi nuk ka ndikime të tilla.

4.8 Ndikimi në erozion

Degradimi fizik dhe erozioni i tokës mund të jenë problem për shkak të terrenit. Siç është e shpjeguar edhe në studimin gjeologjik toka ku do të ndërtohet vepra është e qëndrueshme dhe janë bërë llogaritjet e nevojshme që objektet dhe terreni ku ato do të ndërtohen të jenë po ashtu të qëndrueshme.

4.9 Ndikimet ndërkufitare

Projekti nuk prek mjedisin ndërkufitar, sepse të gjitha burimet rrjedhin dhe krijohen brenda territorit të shtetit Shqiptar, nuk bën pjesë në projektet me ndikim ndërkufitar.

4.10 Ndikimi në regjimin e zhurmave dhe vibrimeve.

Zona e ndërtimit të ujesjellesit është zonë malore-kodrinore. Firma zbatuese do të respektojë standartet gjatë punimeve. Gjatë procesit të zbatimit të punimeve për ndërtimin e infrastrukturës së të ujesjellesit (vendosjes së tubacionit, ndërtimi i depove, pusetave të komandmit, etj.), mund të krijohen zhurma, por ato zgjasin vetëm gjatë fazës së ndërtimit të ujesjellesit dhe niveli i tyre nuk do t'i kalojë normat e lejuara, kështu që kjo nuk do të përbëjë problem për komunitetin e fshatrave dhe habitain përrreth. Kompania zbatuese që do të ndërtojë ujesjellesin merr në konsideratë ndikimin në regjimin e zhurmave dhe do të marrë të gjitha masat për zbutjen e ndikimeve të mundshme negative.

Në fazë e shfrytëzimit të ujesjellesit nuk do të ketë emetim zhurmash.

4.11 Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

➤ Sasise të gjenerimit të mbetjeve

Bazuar në ligjin nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” si dhe VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, ku volumi i gjenerimit të mbetjeve nga rikonstruksioni i ujesjellesit referuar preventivit të punimeve në total volumi i mbetjeve inerte (dheu) që do të depozitohet është 6230 m³. Ndërsa pjesa tjetër e gërmimeve do të pedoret për mbushjen e kanalit të ujesjellesit. Këto inerte propozohet të depozitohen në një vend me sipërfaqe S= 400 m². Lartësia mesatare e venddepozitimit do të jetë 2 m. Pjesa e përkatshme vendodhjes kjo do të përcaktohet me bashkëpunimin dhe kompaninë investitore.

Referuar VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, mbetjet e gjeneruara i klasifikohen sipas pikve:

Pika 13 Mbetje vajrash dhe mbetje të karburanteve të Lëngshme

1301- Mbetje të vajrave hidraulike

1302- Mbetje vaji ingranazhesh, motori dhe lubrifikante

Pika 16 Mbetje të pa specifikuara

16 01 03- Goma jashtë përdorimi

Pika 17. Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhëra të gërmuara nga zona të kontaminuara)

1701- Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika

1702- Dru, qelqe dhe plastika

1705- Dhëra

Pika 20 Mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje Industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë Fraksionet e mbledhura veçmas

20 01 01- Letër dhe karton

20 03 03- Mbetje nga pastrimi i rrugëve

20 03 04- Llumra nga gropat septike

20 01 08- Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat

➤ Trajtimit të mbetjeve

Mbetjet inerte të gjenaruara do të trajtohen sipas VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, është vetë gjeneruesi (në këtë rast Bashkia Lezhe e cila do të largojë/transportojë mbetjet e gjeneruara në landfillet inerte të percaktuara nga Bashkia/ Njësia e Qeverisjes Vendore.

Mbetje vajrash dhe mbetje të karburanteve të lëngshme, që klasifikohen si mbetje të rrezikshme do të trajtohen sipas VKM Nr. 765 date 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”, Kreu IV në pikën 6 ku citohet: Kur krijuesi i VP-ve është person që ka në përdorim vetjak automjete dhe kur ndërrimin e vajit e bën vetë, vajin e përdorur e depoziton në enë të veçanta dhe e dorëzon të subjekti që është pajisur me licencën III.2.B, për transportimin, rikuperimin dhe/ose asgjësimin e VP-ve.

Mbetjet nga gomat e përdorura të automjeteve do të trajtohen sipas VKM nr. 652, datë 14.9.2016 “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura” ku në pikën 5 citohet: Zotëruesi (në këtë rast subjekti **Bashkia Lezhe**) i gomave të përdorura i dorëzon pa pagesë gomat e përdorura të grumbulluesi dhe/ose të magazinuesi dhe/ose të trajtuesi i gomave të përdorura. Në rastin e zëvendësimit të gomave të përdorura me goma të reja në pikat e servisit, zotëruesi i gomave të përdorura i dorëzon ato të servisi.

Mbetjet e urbane të riciklueshme në këtë rast futen kartoni, qelqi dhe plastika që do të gjenrohen do të trajtohen sipas Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar. Në kantierin e punës do të vendosen 3 kosha ku do të vendosen në kantierin e punës dhe do të zbrazen në frekuencë ditore.



Shembull i nje tualeti portativ



Sistemi i menaxhimit te mbetjeve ne kantierin e ndertimit

- Ngjyra:Jeshile (Organike)
- Verdhe:Plastike /qelq
- Blu:(Letër & Karton)

Keto mbetje do te dergohen ne vendin e grumbullimi te percaktuar nga Bashkia/ Njesia e Qeverisjes Vendore, pasi klasifikohen ne mbetje urbane. Llumrat nga gropat septike do te trajtohen sipas VKM nr. 127, datë 11.2.2015 “Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura” ne kreun I pika dh citohet: “Impiant individual ose lokal trajtimi i ujërave të ndotura” është gropa septike, gropa e ujërave të zeza, gropa e banjave, banja në oborr me gropë ose drenazhi francez, i cili shërben për trajtimin në vend të ujërave të ndotura, në zonat ku nuk ka sistem publik kanalizimesh; Sugjerohet qe ne kantierin e punes te perdoren tualeta portativ pasi jane te levisshem dhe puna do jete ne disa fronte.

➤ **Transportimi i mbetjeve**

Transportimi i mbetjeve do te behet nga persona te autorizuar me licence te tipit III.2.B si detyrim i ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar.

➤ **Asgjesimi i mbetjeve**

Materiali qe do te depozitohet eshte kryesisht materiali me perberje shkembore, aluvione te cimentuara, si dhe materialet me perberje dherash te cilat do te depozitohen me vete dhe do te perdoren si mbulesa e ketyre vend-depozitimi ne menyre qe me kalimin e kohes vegjetacioni ne keto zona mund te zhvillohet. Gjithashtu i gjithë materiali qe do te depozitohet do ngjishet, dhe neqoftese eshte e nevojshme do te krijohen te gjitha kanalet drenazhuese perreth vend-

depozitimit ne menyre qe ujerat siperfaqesore te mos pengohen nga rrjedhja e tyre. Projektimi i ketyre vend-depozitimi eshte bere ne menyre te tille ku jane evituar te gjitha konfliktet me objektet qe ndodhen ne kete zone, duke iu shmangur edhe zonave te banuara ne menyre qe te eliminohen edhe rrisqet me te vogla nga prania e ketyre venddepozitimi.

Gjithashtu per te ruajtur keto depozitime nga erozioni apo shkarjet do te behet nje ngjeshje e mire e saj per te shmangur fundosje te ketyre shtresave te tokes. Per te zvogeluar efektin e shpellarjeve te ketyre siperfaqeve nga rreshjet e shiut pjerresite e nevojshme me kanalet e hapura do te formohen ne siperfaqet e ketyre venddepozitimi.

Megjithese nuk paraqitet e nevojshme, por nqs do te jete e tille ne fund skarpatat e ketyre vend-depozitimi mund te ndertohen mure mbajttese (Gabion) lokale me ane te materialit shkembor (Gure te Medhenj) ne menyre qe te evitohen rreshqitjet.

Shkarkimi i materialeve ne shesh-depozitim do te kryhet sipas nje radhe te caktuar qe do te thote, materialet do te shkarkohen me shtresa.

Tabela përmbledhëse e ndikimeve negative dhe pozitive në mjedis (Tabela 3)				
<i>Lloji i ndikimit ne toke</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
<i>Humbje e tokes per kullote.</i>		X		X
<i>Ndryshime topografike te terrenit.</i>	X			X
<i>Prishja e tokes bujqesore.</i>		X		X
<i>Ndotja e tokes nga rrjedhje.</i>		X		X
<i>Ndotja e tokes nga mbetjet e ngurta.</i>	X			X
<i>Ndotja e tokes nga depozitimet e Llumrave.</i>		X		X
<i>Lloji i ndikimit ne cilesine e ajrit</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
<i>Prodhimi i pluhurit.</i>	X			X
<i>Ndojtja nga hidrokarburet, plumbi dhe aerosolet.</i>		X		X
<i>Ndotja nga monoksidi karbonit dhe dioksidit te sqfurit (CO, SO2).</i>		X		X

<i>Lloji i ndikimit ne floren dhe faunen</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
<i>Shkaterrimi i rendesishem i habitave natyrore.</i>		X		X
<i>Rrezikimi i nderhyrjes ne bimet e ujit.</i>		X		X
<i>Ndertimi i rrugeve te reja qe kalojne perms zones se virgjër.</i>		X		X
<i>Perçarje apo izolim te habitave te egra.</i>	X			X
<i>Interference midis rruges natyrore te emigrimit te sisorve.</i>	X			X
<i>Lloji i ndikimit ne uje</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
<i>Trajtimi i ujrave te ndotur.</i>		X		X
<i>Ndotja e ujit prej pluhurit, plumbit, derdhjeve aksidentale dhe substancave te tjera.</i>		X		X
<i>Impakti sekondar ne ndotjen e ujit per tokat bujqesore, ujrat nentokesore etj.</i>		X		X
<i>Modifikim ne drenazhimin e ujrave natyrore.</i>		X		X
<i>Ndotja e ujrave siperfaqesore dhe nentokesore nga llumrat.</i>		X		X

<i>Lloji i ndikimit ne ndotjen nga</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
<i>Rritja e nivelit egzistues te zhurmave.</i>	X			X
<i>Rritja e nivelit te zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinave.</i>	X			X
<i>Rritja e nivelit te zhurmave per njerezit.</i>	X			X
<i>Nivel me i larte i zhurmave per kafshet.</i>	X			X

<i>Lloji i ndikimit ne perfitimin e tokes</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
<i>Shkaterrim objektesh.</i>		X		X
<i>Ndryshime te rendesishme ne programet per te ardhmen e perdorimit te tokes.</i>		X		X
<i>Ndertime objektesh.</i>	X			X
<i>Shpronsime te tokes.</i>		X		X

<i>Lloji i ndikimit per trashegimine kulturore</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
<i>Ndryshime apo demtime te zonave arkeologjike apo me vlere historike e kulturore.</i>		X		X

<i>Lloji i ndikimit ne energji</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
<i>Perdorim i sasive te medha te karburantit per energjik.</i>		X		X
<i>Rritje te rendesishme te kerkesave per burime ekzistuese te energjise apo kerkesave per tipe te reja te energjise.</i>		X		X
<i>Lloji i ndikimit ne interesin publik (Infrastruktura)</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>Po</i>	<i>Jo</i>
<i>Sistemi i ujesjellesit do te kete apo jo nevojte per ndryshim ne kete fushe te interesit publik.</i>		X		X
<i>Energji elektrike.</i>		X		X
<i>Sistemin e komunikacionit.</i>		X	X	
<i>Sistemin e kanalizimit te ujrave te zeza dhe te bardha.</i>		X		X
<i>Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre.</i>	X			X

<i>Lloji i ndikimit ne shendetin e njerezve</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	Po	Jo	Po	Jo
<i>Krijimi i cfaredo rreziku apo mundesie per demtimin e shendetit te njerezve.</i>		X		X
<i>Krijimi i raportit te njerezve me rreziqet e mundshme per demtimin e shendetit te tyre.</i>		X		X

<i>Lloji i ndikimit ne qarkullim dhe</i>	<i>Identifikimi i ndikimit</i>			
	<i>Gjate ndertimit</i>		<i>Gjate shfrytezimit</i>	
	Po	Jo	Po	Jo
<i>Shtime te rendesishme te qarkullimit te automjeteve.</i>		X		X
<i>Pakesime te vendqendimeve te automjeteve apo nevoja per vendqendime te reja.</i>		X		X
<i>Ndikimete rendesishme ne sistemin e Komunikacionit.</i>		X		X
<i>Ndryshime ne qarkullimin apo te levizjes se njerezve dhe mallrave.</i>		X		X

KREU V

TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS, QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT, DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË

Vlerësim i ndikimeve në mjedis janë bërë duke ju referuar legjislacionit përkatës, veçanërisht kërkesave të udhëzimit “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis të një veprimtarie” si dhe duke patur parasysh ligjin “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, etj.

Më poshtë trajtohen ndikimet pozitive dhe negative të projektit në të gjithë elementet specifike mjedisore (sipas metodologjisë së lartpërmendur) gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të ujesjellesit.

5.1 Ndikimi i projektit gjatë fazës së ndërtimit

Ndikimet i klasifikojmë sipas fazave të zhvillimit të projektit dhe natyrës së tyre dhe mund t'i ndajmë:

- Ndryshim peizazhi: nga gërmimet e tokës për hapjen e rrugës, nga ndërtimi i veprave të marrjes, ndërtimi i traseve për tubacionin, ku për ruajtjen e peizazhit linja e tubacionit do të futen në tokë në pjesën më të madhe, për të ulur ndikimin pamor në mjedis. Gjithashtu, fasada depove do të trajtohet dhe harmonizohet me ndërtimet përreth dhe në përshtatje me mjedisin.
- zhurma, pluhuri dhe gazrat djegëse të motorëve të mjeteve të punës.
- zhvendosje e një sasive të madhe zhavorri dhe dheu, të cilët parashikohen të shfrytëzohen.
- dëmtim i bimësisë pyjore, por që do të bëhet rehabilitimi pas ndërtimit.

5.2 Ndikimi i projektit gjatë fazës së shfrytëzimit

Ndikimet gjatë fazës së shfrytëzimit klasifikohen në:

- Probleme të erozionit.

Këto mendohen të zvogëlohen me përfundimin e fazës së ndërtimit me mbjelljen e fidanëve dhe ruajtjen e brigjeve të përroit në degëzimet e tyre pranë zonës së projektit. Punimet që do të realizohen kryesisht gjatë periudhës së zbatimit të projektit, vlerësohet se do të shkaktojnë ndikime në mjedisin rrotull, të cilat janë të domosdoshme të vlerësohen në kuadrin e mbrojtjes së mjedisit.

KREU VI PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT

6.1 Të përgjithshme

Ky seksion përfshin përshkrimin e Planit të Menaxhimit Mjedisor (PMM) të projektit. Qëllimi kryesor i PMM është të sigurojë një proces sa më pak të dëmshëm për mjedisin nëpërmjet masave rehabilituese, të cilat do të minimizojnë dëmtimin e mjedisit dhe rekuperimin e tij. PMM dhe Programi i Monitorimit Mjedisor do të jetë në formën e një drafti në mënyrë që të sigurojë implementimin e rekomandimeve parandaluese dhe të parandalojë ndikimet e mundshme mjedisore të anashkaluar në raportin e VNM-së. Pavaresisht nga kjo, PMM stimulon procedurat dhe rregullat që duhet të ndiqen gjatë ndërtimit dhe për më shumë gjatë operimit të ujesjellesit.

6.2 Plani i menaxhimit të mjedisit të dëmtuar nga zbatimi i këtij projekti

Ky plan synon minimizimin e ndikimeve në mjedis duke marrë masa specifike për secilin ndikim të përshkruara në këtë seksion do të vlerësohet si pjesë e procesit të zbatimit të projektit për të zbutur ndikimet e mundshme nga aktivitetet e ndërtimit. Në paralizim për të përmbushur komponentët e nënprojekteve kryesore të kërkuara nga legjislati shqiptar të aspekteve mjedisore dhe sociale do të strukturohen sipas kuadrit përkatës ligjor. Masat lehtësuese kryesore do të përfshihen, por nuk do të limitohen në këtë pike, pasi gjatë punimeve mund të ketë ndryshime dhe probleme që mund të shoqërohen me ndikim në mjedis.

Ndër të tjera është projektuar që të kihet parasysh nga investitori:

- Përzgjedhja optimale e kapaciteteve dhe e shesh ndërtimit për këtë ujesjelle.
- Projekti dhe ndërtimi i infrastrukturës së re të kërkuar nga ky proces duke marrë në konsideratë dhe respektuar kushtet e mjedisit lokal;
- Parandalimi i krijimit të trafikut në zonë;
- Dëmtimi i mjedisit pyjor në minimumin e lejuar;
- Masat për reduktimin e pluhurave nga punimet ndërtimore
- Masat për reduktimin e zhurmës;
- Masa për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara duke minimizuar erozionin. Kjo, duke zbatuar me përpikmëri projektin e rehabilitimit të mjedisit të hartuar që në fazën para fillimit të punimeve.
- Respektimin e kushteve të lejes/vendimit mjedisor të lëshuar nga Ministria.
- Mbikëqyrjes dhe monitorimit të kushteve teknike për aktivitetet ndërtimore duke zbatuar kushtet përkatëse që do të përcaktohen nga agjenci përkatëse në nivel kombëtar dhe autoriteteve lokale;
- Monitorim të treguesve mjedisorë gjatë punimeve ndërtimore dhe gjatë procesit të rehabilitimit.

6.3 Vlerësimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella

Ajo do të realizohet nga subjekti. Mund të ngrihen prita për të përforcuar mbrojtjen e pyjeve nga erozioni në zonat rreth sheshit të nënobjekteve. Gjithashtu do të kujdeset për mbarështrimin e pemëve që do të mbillen nga shoqëria. Për kullimin e ujërave që do të grumbullohen në sheshin e depozitimit të sterileve do të hapen kanale për drenimin e ujërave jashtë sheshit të depozitimit.

Pas zbatimit të plotë të projektit do të bëhet vlerësimi i efekteve të punimeve të kryera në grumbullin pyjor nëpërmjet monitorimit, duke mbajtur shënime përkatëse periodike.

Për vijimësinë e procesit objekti do të mbahet nën kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet vëzhgimeve të herë pas hershme.

Aktorët bashkveprues e mbështetës në zbatimin e projektit do të:

- Informohen me evidencat përkatëse duke cilësuar për qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e projektit.
- Bëhet monitorimi i të ardhurave (qofshin këto direkte apo indirekte) të përfituara nga implementimi i projektit, duke bërë listimin e përfitimeve dhe vlerën e tyre.

KREU VII

MUNDËSITË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, SI DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN

7.1 Të dhënat e sheshit të depozitimit

Ndërtimi i Ujesjellesit është përlogaritur për afërsisht të krijojë një volum materialesh të gërmuara për t'u depozituar, të cilat do të sistemohen në sheshin e përcaktuar. Kjo masë dherash të gërmuar do të ndahet sipas tipeve ku në mënyrë të veçantë do trajtohet shtresa vegetative e tokës (top soil). Materiali do të sistemohet dhe do të ngjeshet duke harmonizuar relievin e shpatit dhe terrenit të destinuar për vend – depozitim. Faza përfundimtare ka të bëjë me mbulimin e materialit me shtresë dheu të aftë për t'u mbjellë dhe vegjetuar. Kjo sipërfaqe do të mbillet me dushqe dhe bimësi vendase në mënyrë që fenomeni erodues nga shirat dhe ujë të parandalohet, po ashtu bimesia që duhet të mbillet duhet të jete autoktone për të mos thyer pejsazhin karakteristik të zones.

Për të shkuar në venddepozitimet do të përdoren rruget e aksesit.

7.2 Vlerësimi teknik i planifikimit të shesh depozitimit

Planifikimi i këtij vend-depozitimi është bërë në përputhje me terrenin duke e projektuar atë në sinkron me relievin duke shfrytëzuar hapësirat boshe të tij, në hapësira jo të pyllëzuara duke mos patur ndonjë ndikim në mjediset përreth.

Gjithashtu janë marrë parasysh edhe formacionet e materialeve që do të gërmohen dhe që do të depozitohen në projektimin e ketyre venddepozitimi, në mënyrë që të mos shfaqin probleme në stabilitetin e tyre në vetvete, duke evituar ndonjë rreshqitje të dherave të ketyre venddepozitimi.

Materiali që do të depozitohet është kryesisht materiali me perberje shkëmbore, aluvione të cimentuara, si dhe materialet me perberje dherash të cilat do të depozitohen me vete dhe do të përdoren si mbulesë e ketyre vend-depozitimi në mënyrë që me kalimin e kohës vegetacioni në këto zona mund të zhvillohet. Gjithashtu i gjithë materiali që do të depozitohet do ngjeshet, dhe nëqse është e nevojshme do të krijojnë të gjitha kanalet drenazhuese përreth venddepozitimit në mënyrë që ujërat sipërfaqësore të mos pengohen nga rrjedhja e tyre. Projektimi i ketyre vend-depozitimi është bërë në mënyrë të tillë ku janë evituar të gjitha konfliktet me objektet që ndodhen në këto zone, duke iu shmangur edhe zonave të banuara në mënyrë që të eliminohen edhe rrisqet me të vogla nga prania e ketyre venddepozitimi.

Siç e kemi përmendur me lart siguria në stabilitet e këtyre venddepozitimi është studiuar duke pasur parasysh formacionin gjeologjik të materialeve, ku mbi bazën e këtyre parametrevë janë përshtatur edhe pjerresitë e skarpave të këtyre venddepozitimi të cilat variojnë nga 3-4 m trashësi depozitimi. Gjithashtu për të ruajtur këto depozitime nga erozioni apo shkarjet do të bëhet një ngjeshje e mirë e saj për të shmangur fundosje të këtyre shtresave të tokës. Për të zvogeluar efektin e shpëlarjeve të këtyre sipërfaqeve nga rreshjet e shiut pjerresitë e nevojshme me kanalet e hapura do të formohen në sipërfaqet e këtyre venddepozitimi.

Megjithatë nuk paraqitet e nevojshme, por nëqë do të jete e tillë në fund skarpave të këtyre venddepozitimi mund të ndërtohen mure mbajtëse (Gabion) lokale me anë të materialit shkëmbor (Gurë të Medhenj) në mënyrë që të evitohen rreshqitjet.

Punimet e ndërtimit në vend-depozitimin

Punimet e për ndërtimin e vend depozitimit konsistojnë në punime hapje rruge aksesi dhe sistemimi të sheshit për qëllimin që do të kryejnë.

Në sheshin e vend-depozitimit nuk është e nevojshme ndërtimi i ambienteve ndihmëse.

Punimet e ndërtimit do të konsistojnë në:

- Hapja e rrugëve të aksesit
- Ndërtimin e kanaleve për mbledhjen e ujërave të shiut
- Rrethimi i sipërfaqes së shesh depozitimit me mur teli
- Procesi i transportit të materialeve dhe sistemimi i tyre
- Gjenerimi i materialeve të gërmuara
- Ngarkimi i transportimit për në venddepozitim
- Sharkkimi në venddepozitim dhe sistemimi i materialeve sipas kategorive

Në projektin për ndërtimin e ujesjellesit bëjnë pjesë struktura të ndryshme inxhinierike, për ndërtimin e të cilave kryhen punime hapje dhe gërmimi.

Hapja e trasës së tubacionit të presionit ku sasia e dheut ku gjenerohet është me e konsiderueshme, për pasoj ndërtimi i sheshit për depozitimin të materialeve është një domosdoshmëri e pashmangshme.

Transporti i materialeve për në vend-depozitimin është menduar të kryhet në frekuencë të rralla për të shmangur krijimin e përgjeshjeve në vendin e punës. Ngarkimi i materialit do të realizohet me ekskavatore, transporti i tyre do të realizohet me kamion të tonazhit të mesëm.

Depozitimi i materialeve kërkon seleksionim të thjeshtë pasi mbetjet janë të së njëjtes kategorie materiale dherash, gurësh, aluvionesh.

7.3 Sistemimi i materialeve në shesh depozitim

Sharkkimi i materialeve në shesh-depozitim do të kryhet sipas një radhe të caktuar që do të thote, materialet do të shkarkohen me shtresë. Shesh depozitimi është planifikuar të mos ngjeshet, pasi nga vete procesi i mbushjes së tij; mbushje "me shtresë" përfitohet ngjeshja natyrore dhe mekanike të lehtë. Sipas profileve anësore në projektin për vend depozitimin janë të planifikuara me shtresë, trashësia e të cilave është mesatarisht 2 m.

7.4 Mbyllja e shesh depozitimit

Me mbyllje të shesh-depozitimit do të arrihet në dy rrethana:

Kur është arritur kapaciteti maksimal i depozitimit. Kur nuk gjenerohen materiale nga proceset e ndërtimit të strukturave të ujesjellesit dhe në këto pike fillon marrja e materialit nga shesh – depozitimi për të mbuluar terrenin e prekura në masën e nevojshme.

Rasti i dyte eshte marre ne konsiderate te ndodhe keshtu qe mbyllja e shesh- depozitimit do te kryhet kur eshte arritur hapja e nenobjekteve te nevojshme te ujesjellesit dhe finalizimi i nenobjekteve funksionale te ujesjellesit. Me pas fillon marrja e materialit nga shesh – depozitimi per te mbuluar terrenet e prekura ne masen e nevojshme.

Masat për rigjenerimin e sipërfaqes se prekur nga realizimi i punimeve

- Sistemimin e materialit të mbulesës dhe të sterileve që dalin gjate ndertimit.
- Sistemimi i skarpateve para dhe pas ndertimit.
- Depozitimi i dheut (kores se tokes)
- Punimet e mermimit te shtratit te dheut
- Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidane (bime autoktone).
- Mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella.

7.5 Sistemimi i materialit të mbulesës dhe sterileve

Si pasoje e aktivitetit ndertimor qe do zhvillohet per ndertimin e ujesjellesit, paraqitet e nevojshme sistemimi i materialit te germuar dhe gjeneruar, i cili me pas do te perdoret per sistemimin e terreneve te prekura nga germimet.

Subjekti do te sistemoje shkembinjte me permasa te ndryshme ne shesh depozitimin te materialeve. Nje pjere e ketyre materialeve mund dhe duhet te perdoren ne shtratit perrenjve intersektues me qellim shtratimin strukturor te lumit çka do te permiresonte cilesine e ujit duke frenuar mbarjen e sedimenteve ne drejtim te lumenjve dhe detit. Po ashtu me keto gure do te krijohen strukturat mbrojtese dhe muret gabion çka ulin ne mase levizjen e madhe te materialeve nga vendi ku nxirren. Ky material do te depozitohet i ndare ne dy grupe. Ku grupi i pare do te jete materialet jo te afta per mbjellje dhe grupi i dyte do te jete materiali i kores se tokes (top soil), i cili ka aftesi te perdoret per fazen e rehabilitimit me ane te mbjelljes se vegjetacionit.

Nje pjese e aterialeve te ngurta (gure te madhesive te ndryshme) merret e do te depozitohet ne ane te shtratit te vepres per te realizuar kijimin e shtresave vegjetale e mbjedhjen e pemeve per mbrojtjen nga erozioni i metejshem.

7.6 Sistemi i skarpateve para e pas ndërtimit

Subjekti ka per detyre e do te realizoje sistemimin e mirembajtjen e skarpateve te shkalleve ku aktualisht ai eshte i shkaktuar nga ndertimi. Ato do te mbahen nen vezhgim gjate gjithe kohes se shfrytezimit e me pas saj deri ne riaftesimin e terrenit.

Skarpatet do te mbushen me material steril, do te perforcohen me trungje e do te hidhen dhera te mbuleses mbi to. Mbasi te jete lidhur toka do te filloje mbjedhja e pemeve.



Foto ilustruese, Shembull sistemimi skarpate me mure gabiona

7.7 Depozitimi i dheut (kores së tokës) dhe punimet e sistemimit të shtratit të dheut

Dheu i grumbulluar gjatë hapjes së shesheve të ndërtimit do të sistemohet në ato pjesë të sheshit që nuk krijojnë probleme gjatë ndërtimit të nënveprave të ujesjellesit dhe në rastin konkret shtresa e kores së tokës do të zhvishet në të gjithë gjatësinë e tij, ku projekti do të zhvillohet. Kjo masë dheu (korja e tokës) do të ruhet për ripërdorim në rehabilitimin e terreneve dhe përmirësim të ndikimit vizual, kjo me qëllim që shpatet e formuara nga gërmimet të risistemohen, gjë e cila ndihmon edhe veprat e projektit në jetëgjatësinë e tij, në temperaturën e ujit në linjën e tubacionit të presionit. Këto sipërfaqe, të cilat do të risistemohen, do të mbillen me bimësi vendase, të cilat rrisin qëndrueshmërinë e shpateve, e cila në përfundim të tij nuk do të ketë ndikim në anën vizuale të mjedisit. Para se të realizohet procesi i mbjelljes së terrenit të krijuar me bimësi vendase duhet që dheu i hedhur të shkriftohet në mënyrë që të ofrojë kushte të përshtatshme për mbjelljen e fidanëve.

Shembull sistemimi për vendgrumbullimin, ku është mbjellur bar si vegetacion



7.7.1 Ndikimet

Aktiviteti që parashikohet të realizohet ka të bëjë me ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e fermerit (përdoruesit) për rëndësinë që ka pyllëzimi i kësaj sipërfaqeje pyjore. Mendojmë se projekti që kemi hartuar është mjaft inovativ dhe paraqet mjaft interes për komunitetin, i cili në ditë pyjesh do të njihet:

- Me rëndësinë e kryerjes së punimeve të pyllë të sipërfaqeje pyjore
- Me teknologjinë në punimet e pyllëzimit
- Me efektivitetin e punimeve të pyllëzimit
- Ngritjen e kapaciteteve të komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave.
- Ndërgjegjësimi i fermerëve për domosdoshmërinë e kryerjes së punimeve, të tilla në funksion të shtimit të efekteve pozitive, shtojmë këtu edhe mundësinë e vjeljes së një prodhimi cilësor të frutave të lajthisë për eksport, duke rritur të ardhurat e tyre dhe duke ndikuar drejtpërdrejtë në gjithë aktivitetin e tyre jetësor.
- Do të nxitet transferimi i kësaj eksperience në komunitetin përreth e më gjerë
- Nga ky projekt do të përfitojë direkt përdoruesit e pyjeve në këtë sipërfaqe që realizohet ky projekt.

Mjedisor

- Rruajtja e zhvillimi i biodiversitetit, sekuestrimi i karbonit sipas marrëveshjes së Kiotos në kuadrin europian (nga rruajtja e tokës dhe instalimi i bimësisë natyrore e të kultivuar).

Ekonomike

- Përfitimet shkojnë më larg se sa vetë komuniteti, dhe konkretisht ndikimi në GDP.

Social Kulturore

- Sigurimi i nevojave të komunitetit, punësimi etj.

KREU VIII

MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

8.1 Masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit

Shoqëria zbatuese që do të ndërtojë dhe shfrytëzojë ujesjellesin (Bashkia) merr në konsideratë ndikimin në mjedis dhe do të marrë të gjitha masat për zbutjen e ndikimeve të mundshme negative. Në rast ndotje aksidentale, shoqëria merr përsiper demet e ndikimit të shkaktuar në mjedis. Ndërtimi i Ujesjellesit mund të demtojë mjedisin si rrjedhojë e:

Demtimeve (ose aksidenteve) të veprave të vecanta inxhinierike për të cilat do të merren masat e duhura për rehabilitimin e tyre.

- Kryerjes së punimeve restauruese në pjesën e demtuar.
- Ndonjë avarie gjatë procesit të punës
- Instalimi i veprave së marrjes me kapacitet marrës të ujit me të madh se atë të llogaritur.
- Ndërtimi i ujesjellesit ka koston e vet mjedisore, e cila është e balancuar me përfitimet e shoqërisë, njësisë administrative dhe komunitetit nga ky investim.

8.2 Plani i monitorimit të mjedisit

Projekti në fjalë ka vlera të mëdha inxhinierike dhe përfitime të konsiderueshme ekonomike. Për tipin e aktivitetit që kërkon të ndërmarret Bashkia, në fazën e shfrytëzimit, ujesjellesa të tilla mund të punojnë shumë mirë në kushtet e mikrosistemit, duke u bërë një garanci e furnizimit me ujë 24 orë për zonën.

Projekti ka nevojë për monitorim mjedisor rigoroz nga organet kompetente mbikqyrese në kuadrin e mbajtjes nën kontroll të parametrave mjedisor si dhe të veprave të vecanta inxhinierike si hapja e puseve për marrjen e ujit, tubacionet nën presion, depot, pusetat etj.

Pas ndërtimit të ujesjellesit duhet të mbahet nën mbikqyrje rehabilitimi i zonave të prekura nga punimet. Monitorimi i ndikimit në mjedis duhet të kryhet nga inspektore të specializuar për mbrojtjen e mjedisit, të kontrollit të ujërave, shërbimit pyjor, pushtetit vendor dhe qendror, MM – ja, AKM - ja dhe ARM – ja.

8.3 Masat për parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve nga zjarri

Bazuar në kuadrin ligjor shqiptar:

- Ligji Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- VKM nr.290, datë 30.04.2004 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota”.
- VKM nr.1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve”.

Është hartuar një plan masash për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të projektit rikonstruksioni i rrjetit të ujesjellesit për fshatin Dajç në Bashkinë Lezhë.

Vlerësimi i masave për mbrojtjen nga zjarri

Mundësitë për të rënë zjarri në pyje për territorin ku do të zhvillohet projekti si rezultat i veprimtarisë për zhvillimin e projektit janë vlerësuar në dy faza.

- Faza I. Ndërtim montim i Ujesjellesit
- Faza II. Shfrytëzimi i Ujesjellesit

8.3.1 Faza I. Ndërtim montim i Ujesjellesit.

38

Në këtë fazë janë parashikuar të bëhen këto procese: punimet e gërmimit, transportit dhe saldimit. Burimet për rënie zjarri janë:

- Veprimtaritë e gërmimit dhe jeta e kantierit nga shkëndijat elektrike apo motorrike të mjeteve të rënda
- Nga shkëndijat që lindin gjatë fërkimit mekanik të mjeteve të gërmimit me shkëmbin.
- Veprimtaria e transportit
- Nga shkëndijat elektrike apo motorrike të mjeteve të rënda
- Nga rrjedhjet e karburanteve gjatë transportit
- Veprimtaria e saldimit. Nga shkëndijat që lindin gjatë saldimit me elektroda si dhe prerje të mundshme të Materialeve metalike me gurë fresibël.
- Kantieri.
- Instalimet elektrike në kantier
- Veprimtaria jetësore e punonjësve në kantier (kuzhina, djegie e pakujdesshme e Materialeve te ndezshme, etj)
- Pakujdesitë nga pirja e duhanit
- Venddepozitimi i karburanteve të mjeteve motorrike

8.3.2 Masat e parashikuara për fazën I.

Punonjësit duhet të trajnohen për masat në rastet e rënies së zjarrit, në shmangien dhe parandalimin e rënies së zjarrit si dhe në fikjen e saj. Ky trajnim duhet të përqëndrohet në:

- Përdorimin e mjetit motorrik për të marrë Materiali inert, që do të shërbejë për fikjen e zjarrit.
- Përdorimin e fikëseve të zjarrit
- Lajmërimin e personelit teknik të kantierit
- Kontrollin e gjendjes se makinerive për rrjedhje të mundshme të karburantit.
- Në veprimtarinë e gërmimit duhet të kihet parasysh këto masa paraprake:
- Në vendet/frontet ku do të kryhet gërmimi, mjetet duhet të jenë të pajisura me fikëse zjarri,
- Duhet të kenë mjete si lopata dhe kazma
- Në vendet ku verifikohen rrjedhje karburanti nga mjetet e gërmimit duhet të eliminohen.
- Në veprimtarinë e transportit duhet të kihet parasysh këto masa paraprake:
- Kualifikimin e manovratorëve për përdorimin e mjeteve të shuarjes së zjarrit si dhe në lajmërimin e personelit teknik të kantierit
- Pajisja e makinerive me fikëse të zjarrit
- Kontrollin e gjendjes se makinerive për rrjedhje të mundshme të karburantit.
- Në veprimtarinë e saldimit duhet të kihet parasysh këto masa paraprake:
- Marrjen e masave për një ambient të pastër nga lëndë që bëhen burim ndezjeje zjarri apo lëndëve që digjen lehtë
- Kualifikimin e saldatorëve për përdorimin e mjeteve të shuarjes së zjarrit si dhe në lajmërimin e personelit teknik të kantierit
- Në frontet e punës duhet të ketë mjete që ndihmojnë në fikjen e zjarrit si lopata, kazma dhe fikëse zjarri.
- Në kantier duhet të kihet parasysh këto masa paraprake:

- Marrjen e masave për një ambient të pastër nga lëndë që bëhen burim ndezjeje zjarri apo lëndëve që digjen lehtë
- Kualifikimin e punëtorëve për përdorimin e mjeteve të shuarjes së zjarrit si dhe në lajmërimin e personelit teknik të kantierit
- Në frontet e punës duhet të ketë mjete që ndihmojnë në fikjen e zjarrit si lopata, kazma dhe fikëse zjarri.
- Të mos lejohet pirja e duhanit.
- Kontrollim i herëpashershëm i venddepozimit të karburanteve për rrjedhje të mundshme.
- Largimi ditor i mbeturinave në venddepozimet e caktuara nga komuna për shmangien si burim zjarri.

8.4 Faza II. Shfrytëzimi i Ujesjellesit

Në këtë fazë masat për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri përqëndrohen tek kanieri si i vetmi burim i mundshëm për rënien e zjarrit. Për këtë sipas legjislacionit në fuqi, është hartuar një plan i posaçëm për mbrojtjen kundër zjarrit si më poshtë vijon në zbatim të kuadrit ligjor:

- Ligji nr.107/2014, date 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, I ndryshuar si dhe VKM e tjera në kuadër të këtij ligji.
- Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

KREU IX

MONITORIMI I MJEDISIT GJATË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË REHABILITIMIT TË MJEDISIT.

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës dhe mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kriterëve shkencore, përsa i përket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve, ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”

Investitori do të monitorojë këto treguesë të trysnisë në mjedis vetëm gjatë fazës së punimeve ndërtimore dhe konkretisht elementët e mëposhtëm:

- Për ajrin duhet të monitorojë Lëndën e Ngurtë Pezull (LNP) dhe zhurmat (dB).
- Për ujin, duhet të monitorojë Lëndën e Ngurtë Pezull (LNP), konduktivitetin.
- Për tokën, nuk alikohen detyrime.

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit dhe në rast të kundërt, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo tre muaj të dorëzohet një relacion periodik i shkurtër, ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto.

KREU X KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të këtij studimi arrijmë të nxjerrim disa përfundime të rëndësishme dhe disa rekomandime te nevojshme për të bërë të mundur zbatimin e projektit me ndikime sa më të pakta në mjedis nga kompania që do të beje zbatimin e projektit dhe bashkia Lezhe.

11.1 Konkluzione

- Projekti që është paraqitur, gjatë hartimit të tij, ka marrë parasysh respektimin e kushteve mjedisore, kjo në saj të kushteve të relievit të zonës dhe zhvillimit të saj, projektin e rehabilitimit të hartuar për këtë qëllim dhe rekomandimet e ekspertit të mjedisit.
- Momentet më kritikë të ndikimit në mjedis janë: gërmimi për punimet e ndërtimit dhe sistemimi i dheut të punimeve të ndërtimit të veprave dhe të kanalit të shtrirjes së tubacioneve, erozioni i mundshëm i sipërfaqeve të zbuluara në mënyrë të përkohshme, mbetjet e ngurta të gjeneruara, zhurma e motorëve dhe mjeteve të ndërtimit.
- Mbetjet e ngurta të gjeneruara janë parashikuar të menaxhohen sipas kriterëve të kohës dhe sipas një plani në përshtatje me kushtet konkrete të vendit.
- Punimet për hapjen e kanalit, ndërtimin e veprave..etj do të bëhet me material natyral, çka do të garantojë gërshetimin e natyrshëm të saj me mjedisin përreth.
- Për ndërtimin e këtij ujesjellesi është bërë një konsultim me banorët e zonës, çka janë dakort me ndërtimin e këtij ujesjellesi, i cili do të sjellë zhvillimin e kësaj zone. Gjate ndërtimit dhe funksionimit të ujesjellesit do të punesohen banorë të zonës sipas profesioneve të caktuara.
- Projekti nuk prek toka bujqesore pasi tubacionet do të kalojnë në rrugë.
- Rehabilitimi i plotë i inerteve të skarpave dhe të kanalit të veprave në përgjithësi do të reduktojë ndjeshëm ndikimin në mjedis.
- Projekti përputhet me planin e zhvillimit të zonës, në vecanti me planin e përgjithshëm vendor të bashkisë Lezhe.
- Ndërtimi i këtij ujesjellesi është menduar që të integrohet nga ana funksionale me rrjetin infrastrukturor të zonës.

11.2 Rekomandime

41

Me qëllim që të kemi një ndikim minimal në mjedisin e zonës në tërësi nga zbatimi i projektit, rekomandojmë:

- Të përcaktohet, në bashkëpunim me autoritetet vendore, sa më shpejt të jetë e mundur, vendi i mundshëm i ndërtimit të përkohshëm të kantierit të ndërtimit.
- Të përdoret sasia e dheut të gjeneruar nga gjermimet për të rehabilituar sipërfaqet e dëmtuara, si dhe tepricat të depozitohen në vende të caktuara nga njësia administrative, ose të menaxhohen në mënyrë të pa dëmshme për mjedisin.
- Të regjistrohen pemët e prera dhe të mbillen bimësi autoktone në sipërfaqet e dëmtuara pas sistemimit të tyre me dheun e gjërmuar nga sipërfaqja. (Sipas projektit të rehabilitimit në raport 1 me 3).
- Përreth veprave të ujesjellesit të mbillet me kurorë pemësh të larta, në mënyrë që të reduktohet impakti negativ në pamjen e zonës.
- Të aplikohet lagia e rrugëve të trasesë së kanalit dhe të kantierit me qëllim reduktimin e pluhurit. Ujërat e kantierit të orientohen.
- Boja e përdorur për lyerje (me qëllim mbrojtjen nga ndryshku) të ketë ngjyrë të përshatshme, që të gërshetohet natyrshëm me mjedisin, por edhe përbërje kimike të parrezikshme për të.
- Të respektohen kushtet dhe rregullat e mbrojtjes ndaj zjarrit gjatë aktivitetit ndërtimor të ujesjellesit.
- Të respektohen detyrimet dhe kushtet e vëna në lejen/vendimin mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe AKM.
- Të kryhet monitorimi periodik i aktivitetit, si gjatë fazës së ndërtimit dhe gjatë fazës së funksionimit të aktivitetit. Këto të dhëna të monitorimit të dorëzohen rregullisht pranë Drejtorisë Rajonale të Mjedisit të Prefekturës përkatëse, si dhe të vihen në dispozicion të publikut të gjerë dhe organizmave të tjera të identifikuar si palë të prekura ose palë interesi.
- Projekti i zbatimit të zbatohet me përpikmëri dhe brenda sipërfaqeve të paracaktuara, duke realizuar njësoj si në projekt.
- Të mos anashkalohen detyrimet e shoqërisë zbatuese për rehabilitimin e zonës së dëmtuar dhe rrugëve të reja.
- Të zbatohet me përpikmëri Plani i Rehabilitimit dhe të kryhet monitorimi i mbjelljeve bimore deri në mbarëvajtjen e gjelbërimit total të zonës.
- Të respektohet me rigorozitet i gjithë kuadri ligjor në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet e tij.

RAPORTI I VLERESIMIT NDIKIM NE MJEDIS U PERGATIT NGA GRUPI I PUNES I PERBERE NGA:

Expert Mjdisi: Kristaq GJOKA

Expert Mjdisi: Yzeir MIRAKA